

Besimtari

Gazetë mujore. Botues: Shoqata Bamirëse Islame Shkodër
Viti III i botimit, Mars 2009 Nr. 23. Çmimi 20 lekë.
www.gazetabesimtari.com; e-mail: gazetabesimtari@yahoo.it

Kryeredaktor Selim Gokaj

PORTRETI I VERTETE I BIZNESMENIT BOSH NJAK DAMIR FAZLLIQ

Ne Shqiperi eshte bere norme qe mediat te gjuajne dhe te bejne viktimat personalitetet dhe figura politike te cilet jane te piketuara nga qendra dhe qarqe te caktuara, si mrenda dhe jashte Shqiperise, qe jane te interesura qe keto politikanet, ose biznesmene te penalizohen dhe mundesisht te dalin jashte loje permes nje lakimi te panderprere ne keto media, ku mashtrimi eshte baza nga ku keto media nisen per te informuar opinionin publik per keto figura ekonomike, politike, ose te nje fushe tjeter te jetes. Viktime e rralles kesaj here ra biznesmeni boshnjak, Damir Fazlliq, i cili ishte afruar qeverise shqiptare, qe te ndihmoje ekonomine shqiptare permes investimeve te tij ekonomike dhe transaksioneve monetare te shitblirjes, e drejte e secilit biznesmen qe mund te vije ne Shqiperi. Per ta bere sa me te maskuar qellimin e sulmin ndaj biznesmenit Fazlliq, mediat shqiptare, permes nje aleance te fshehur, por krejtesisht te dirigjeshme nga shkopi i nje dirigjenti anonin, i piketuan sulmet tek kontaktet e Fazlliqit me kryeministrin Berisha dhe tek e bija e tij, Argita, qe kishte qene avokate e biznesmenit bashnjak ne zyrtarizimin e aktivitetit te tij shumeplanesh. Akuzat ndaj Damir Fazlliqit u fryne si nje tullumbace nga opozita e majte, e cila i vuri edhe nofken "sebo- boshnjaku Fazlliq", ne perpjekje per te krijuar idene se Berisha po bashkepunon me serbet, ne nje kohe qe opinionin publik shqiptar dhe me gjere nuk e harron Edi Ramen qe pruri qoftexhijte serbe, per te shitur qofte ne mes te Tiranës dhe i pat dhene kengetarit racist dhe antimusliman serb, Bregovic, celesin e Tiranës. Por, tollumbacja e akuzave fallso per biznesmenin boshnjak u shpertheu ne dore atyre qe i ngriten, pasi Damir Fazlliq foli i qete dhe i sakte ne emisionin "Opinion" tek Klani dhe shkoi ne prokurori, ku deshmoi me fakte se ai ishte biznesmen i paster,



serioz dhe i paimplikuar ne aferat korruptive dhe pastrim parash. Po kush eshte ne te vertete portreti real i biznesmenit boshnjak, Damir Fazlliq? Ai eshte pjese e rendesishme e trungut te nje nder familjet me te mira ne Sarajeve, e njohur per pasurine dhe bamiresine te cilat nuk mund te kuptoheshin pa njera-tjetren. Damir Fazlliq eshte nje biznesmen e njohur ne Bosnje dhe jashte hapësirave te saj dhe biznesin e tij e ka ngritur mbi bazen e trashigimnise familjare, biznes per te cilin nuk eshte akuzuar se funksionon mbi bazat e korrupsionit dhe te pastrimit te parave, sepse biznesmeni, Damir Fazlliq, eshte nje musliman i cili e fal ditën e xhuma ne xhami me xhemat dhe Allahu e ka shperblyer edhe me nje grua muslimane te perkushtuar, e cila eshte e mbuluar, sikur se grate e tjera te vellezerve te Damir Fazlliqit. Kane kaluar pak dite, kur ky biznesmen musliman boshnjak (dhe jo sebo- bashnjak) ka investuar per miremajtjen e tri xhamiave ne Sarajeve: Fatih- xhami

, Hasan Gazi dhe Krajl Arafat- xhami. Prove dhe fakt per te lartësuar portretin Damir Fazlliqin dhe familjen e tij eshte lufta e viteve 1992-1995 ne Bosnje, kur Fazlliqet nuk e braktisen Bosnjen, por qendruan ne mbrojtjen e saj dhe ne dhenien e ndihmave per refugjatet dhe banoret e izoluar nga bombardimet serbe ne Sarajeve. Pas mbarimit te luftes, ku serbet paten rrenuar dhe djegur mbi 800 xhamia, familja Fazlliq ndertoi ne Foce nje xhami madheshtore me 3500 vende per t'u falur, e cila ka kushtuar 3,5 milion ero. Kete xhami e inaguroi Damir Fazlliq me 24. 7. 2003. Ne nje interviste te dhene per median vizive, B92, me 11 shkurt 2009, Damir Fazlliq ka deklaruar se ai e zgjodhi Shqiperine per te investuar dhe per t'u marre me biznes si vend musliman por, pas sulmit dhe penalizimit masiv, qe bene mediat, ai tashme eshte shume i zhgenjyer. Sulmi kunder Damir Fazlliqit na kujton sulmet qe u bene kunder biznesmenin arab, Jasin Kadi, te cilit i sekuistruan pasu-

rite dhe llogarite bankare, ne emer te nje terrorizmi fantazem, akuza qe u rrezuan nga gjykatat shqiptare. Duket se per biznesmenet muslimane, qe vijne ne Shqiperi per te investuar, nuk jane kohe te mira, sepse licence per te operuar biznese te tilla ne Shqiperi eshte veshtire qe te gjendet. Por, nje gje tashme eshte e qarte. Mediat shqiptare dhe opozita e majte, qe qendron pas saj dhe prapavija e fshehte qe e nderseu kete opozite kunder biznesmenin boshnjak, Damir Fazlliq, eshte demaskuar ne syte e opinionit publik shqiptar, sepse deshmitet dhe faktet e depozituara ne emisione televizive dhe ne gjykate nga Damir Fazlliq ne Shqiperi ishin argumente te padiskutueshme te pastertise se ketij biznesmeni musliman boshnjak, i cili erdhi per te ndihmuar vellezerit e tij muslimane shqiptare, pa e ditur mire se cila eshte pozita reale ekonomike dhe politike e tyre sot ne Shqiperi.

Selim Gokaj

Vizitë në “Boshtin e të Keqes”

T dashur miq, Assalamu aleikum

Nga data 3 deri 15 shkurt 2009 apo 15 deri në 27 bahman 1387 isha në Iran. Arsyet pse shkova në Iran janë të shumta. Pikë së pari duhet të pranoj që ky vend më ka magjepsur që kur kam filluar të mësojë mbi fenë islame. Ajatollahët e Iranit të cilët sfidonin perëndimin dhe kishin një mënyrë tjetër jetese nga ato të botës së degjeneruar ku ne jetojmë sot, kanë ndezur gjithmonë kureshtjen time për ta vizituar këtë vend. Arsyeja e dytë lidhet me dëshirën time për të kuptuar më mirë shiizmin, gjendjen e muslimanëve në botë por edhe një formë demonstrimi të Islamit politik në botën moderne. Për këto arsye disa javë më parë aplikova pranë Universitetit të al-Mustafasë në qytetin e Kum-it (Qom) që të ndjek një shkollë të shkurtër dimri mbi Islamin dhe demokracinë. Pas pranimit në shkollën dimërore vendosa që të largohem perkohësisht nga preokupimet e mia dhe të vizitoj të pavizitueshmin; Iran. Por këtu duhet të pranoj që përpara se të nisem hasa në një seri peripeçishë dhe dilemash. Pikë së pari kisha një mosvendosmëri në vetvete – nëse duhet ta vizitoja Iranin apo jo – pasi, si nxënës i historisë dhe monitorues i zhvillimeve botërore që jam – isha mëse i sigurtë që vizita ime do të përcillej nga një seri spiunazhesh në Shqipëri dhe në Ballkan. Në listat tonë të internetit ne kemi lexuar disa vite më parë sesi SHIK-u në bashkëpunim me shefat e tij bushistë monitoron, fotografon, përgjon dhe ndjek të gjithë fondacionet iraniane dhe islame në Tiranë. E njëjta gjë bëhet edhe në vendet e tjera të Evropës, sidomos pas shpalljes nga amerikanët të luftës së tyre kundër islamit. Dhe ne muslimanët e shtypur që rrojmë në një botë ku sundon Vëllai i Madh judeo – kristian, i cili të rreh sa me kulaç aq edhe me kërbac, duhet të mendohemi shumë herë përpara se të bëjmë diçka. Mua jo në pak raste ish-agjentë të sigurimit të shtetit si Xhavit Shala dhe Piro Misha më kanë akuzuar në shkrimet e tyre si ‘vehabi’. Po tani që do të vizitoja Iranin çfarë do të më akuzonin? Që jam bërë ‘shija’? Aferim!

Megjithatë, dilemës dhe parandjenës që vizita ime do të përcillet me shumë përgjime kaurësh historikë, më në fund dhe pasi isha mprehur tamam si ai fëmija adoleshent i cili për të kapur të pamundurën bën çdo marrëzi, edhe unë dilemës time mbi Iranin i dhashë një përgjigje të prerë; do të shkoj. Duke menduar që në këto vitet e fundit Iranin e kanë vizituar një sërë anti-muslimanësh shqipfo-

lës, që nga Piro Misha, Remzi Lani, Fatmir Toçi etj, shumë muslimanë, gazetarë dhe zyrtarë të Shqipërisë, dhe për më tepër kur mendova që të krishterët protestantë, katolikë dhe ortodoksë vizitojnë sa herë të duan dhe pa ndonjë shqetësim Amerikën, Vatikanin, Greqinë, Serbinë dhe Rusinë, unë i thashë vetes; mos janë më të mirë sesa unë ata? Pse fjala bie katurdari nga Berati, Erion Velija dhe të tjerë protestantë të sojit të tij në Shqipëri duhet të vizitojnë Shtëpinë e Bardhë dhe Amerikën dhe brohorasin pro disa vrasësish dhe tiranësh si presidenti Bush sa herë të duan, ndërsa unë duhej të frenohesha nga Irani? Inati më shtyu që të mposhtë pavendosmërinë dhe të shkoj.

Megjithatë, përveç shqetësimit me hafijet e Tiranës, fakti tjetër që më shtyu të mendohem përpara vizitës së Iranit janë edhe disa miq të mi muslimanë. Dy hoxhallarë psh. kur mësuam që do shkoja në Iran u shqetësuan për shëndetin e imamit tim nga ‘shiitët e rrezikshëm’ “safavidë” dhe “rrafidhi”. Ndërsa një mik i moshuar i cili më do të mirën dhe shqetësohet për të ardhmen e islamit në Shqipëri kur mësoi mbi shkollën time në Iran më urdhëroi: “Mooooo! Mos shko në Iran pse do na fusësh në belë me Amerikën!” Mikut tim të moshuar i cili është rritur me frikë që në kohë të Enver Hoxhës dhe tani pas Enverit i del Amerika në ëndërr, unë ju përgjigja pak labçe dhe pasi i futa një kompliment Amerikës dhe zagareve të saj në Shqipëri i thashë “Aman o ... ne ku ta gjejmë që të jemi në belë me Amerikën. Pse po hymë në belë, Amerika na pushton dhe pastaj na mban me bukë. Por halli është që ne Amerika na ka harruar dhe na trajton si lopë në këto kohë të kauro-kracisë.” Kështu pra, me gjithë këshillat e miqve, me fobitë që vizita e Iranit shkakton në mendjen e muslimanëve të shtypur, unë i thashë vetes; duhet provuar edhe Irani.

Për këto arsye në datë 2 shkurt, nisa vizitën time drejt vendit të cilin kriminelin më i madh i krishterë i shekullit të 21-të, Xhorxh Bush e ka cilësuar si vendin kyç në tre vendet që ai cilësoi si Boshti i të Keqes - Axis of Evil (Irani, Iraku, Korea e Veriut). Me këtë fjali në kokë nisa të eksploroj vendin për të cilin ushqehet aq shumë histeri në botën e Kryqit dhe Yllit të Davidit.

* * *

Vizitën time drejt Iranit e nisa nga Tirona, duke marrë linjën e Türk Hava Yollarit. Rrugës për në Teheran ndalova në Turqi, ku si gjithmonë, aty, i dhashë ‘selom’ zemrës së kalifatit tonë osmanlli, Stambollit, piva

çaj allaturka me miq të vjetër dhe i dalldisur si i sëmuri i Bosforit, sodisja i magjepsur xhamitë hijerënda të qytetit ku Islami i sulltan Mehmetit qëndron ende i gjallë dhe vital mbi gërmadhat e Krishtërit trinitar të Kostandinin. Avionin për në Teheran e morra në darkë vonë nga Stambolli. Në terminalin e aeroportit Atatürk pashë shumë iranianë që prisnin në radhë për të hipur në avion. Çfarë më bëri përshtypje këtu ishin dy gjëra. Në njërin anë disa iraniane ngjanin shumë me disa femra të rrugëve të Tiranës, që mbajnë barkun jashtë dhe ekspozojnë muskujt e tyre për të joshur djelmërinë, dhe në anën tjetër ishin baulet e mëdha që iranianët mbanin nëpër duar për të hypur në kabinën e avionit. Pasagjerët iranianë dukeshin aq tahmaqarë sa që përveç valixheve me rraqe që kishin futur në bagazhin e avionit, në kabinë tërhiqnin torba të tjera me rraqe – thua se nuk kanë dalë kurrë më parë nga Irani. Pas mbërritjes në Iran dhe vizitës së Teheranit, kuptova që klasa e pasur iraniane e cila humbi pozitën e saja pas revolucionit islamik të Iranit, vuan aq shumë për ti ngjarë perëndimit – sa që tahmaja e saj për rroba “Made in Uest” shkon që nga blerja si të babëzitur të Armany “Made in Turkey”, te operacionet e shpifura të hundës që bëjnë në klinikat e Teheranit e deri në disa raste te ofrimi i kollajtë i seksit me çdo të huaj që i premtan kësaj klase mundësinë për të prekur me dorë mirazhin e rremë të perëndimit dhe arratisjen nga Irani.

Por përveç iranianëve, linja Stamboll – Teheran ishte mbushur plot edhe me të huaj. Edhe pse perëndimi ne muslimanët na tremb nga të vizituarit e Iranit – në bord të avionit pashë disa dhjetra italianë, britanikë dhe ndoshta disa turikuqë amerikane të cilët udhëtonin sëbashku me mua drejt ‘Boshtit të së keqes’. Prezenca e tyre në kabinën e avionit sikur më qetësoi disi. Duke parë disa anglishtfolës turikuq dhe inxhinierë italianë i dhashë ngushëllime vetes. Boshti i të keqes paska edhe disa kaurë – i thashë vetes.

Avioni i linjës turke mbërriti në Teheran rreth orës 2 të natës. Kur avioni preku tokën iraniane, çupkat iraniane të cilat në Stamboll ishin veshur si madam Çiljeta që i këndon të ndejturave të saja të mira, tanimë që erdhën në vendin e ajatollahëve, rregulluan pamjen, mbuluan muskujt e dalë, vendosën nga një shami në kokë, tërhuqën baulet e tejbushura me rraqe Made in Turkey dhe dolën nga avioni si zonja të vërteta. Kur pashë këtë lloj transformimi të çiljetave iraniane në çupka dhe zonjëza shamikuqë dhe shamizeza, i thashë

vetes; këtu në Iran duhet të vijë ndonjëherë edhe Çiljeta, zonja e parë e Francës rruspia Madam Sarkozy dhe kullerat e Kosovës që i këndojnë të ndejturave të çiljetave të botës sonë të degjeneruar. Irani dukej prem-tues.

* * *

Në Teheran mua më priste një djallë nga Universiteti, i quajtur Mehdi. Mehdiun fillimisht mezi e gjeta, pse ai më kërkonte gjetkë e unë prisja te informacioni i aeroportit. Ndërsa prisja Mehdiun një taksixhi që dinte anglisht, përpak sa nuk më kullufiti 90 EURO nga 30 EURO që bënte taksia. Gjithësesi vajzat me shami të informacionit ma gjetën Mehdiun dhe pasi na bashkuan bashkë ne nisëm rrugën për të shkuar drejt të universitetit misterioz që më priste në terrin e natës.

Me Mehdiun fola me duar e me këmbë, pasi ai si jexhuxh maxhuxhët, nuk merrte vesh asnjë gjuhë por vetëm persisht. Të dy hipëm në makinën e tij të modelit të vjetër iranian Samand dhe nisëm rrugën drejtë Kum-it, Vatikanit të shiizmit iranian. Gjatë rrugës së gjerë me tre korsi për në Kum, mua më mërziste fakti që, që nga do që hidhja sytë përreth shihja tabela në persisht. Doja të kuptoja se ku isha, çka shkruhej aty, sa kilometra rrugë na mbeteshin etj. Megjithatë shkrimet persisht, mua që kam kohë që nuk lexoj në gjuhën arabe – më acaroni. Më dukej vetja sikur isha në një planet tjetër. Gërmat arabe më dukeshin aq të huaja sa që i janë dukur edhe gërmat latine të huaja gjyshërve tanë në kohë të Haxhi Qamilit, kur ata u çuan në luftë kundër Fuqive të Krishtera të Evropës, të cilat ju hoqën me dhunë gërmat arabe muslimanëve shqiptarë dhe ju sollën gërmat latine për të shkruar shqipen. Në një raport që konsulli britanik në Durrës i çonte kryeministrit Eduard Grey në Qershor 1914, i tregonte që shqiptarët e Kavajës, Tironës, Durrësit, Shijakut, Elbasanit, Çermenikës dhe Gollobordës ishin rebeluar kundër Evropës, pse kaurët e Princ Vedit i imponuan shqiptarëve gërmat latine dhe ju mbyllën shkollat fetare. Në peticionin e tyre, muslimanët e Shqipërisë së Mesme i kërkoni Evropës që nëse gjuha shqipe do shkruhet ndonjëherë, ajo të shkruhet me gërma arabe dhe simbol i tyre kombëtar duhej të ishte hëna me yll dhe jo ai zogu i prapë – shqiponja me dy kokë që këta quanin – sorra e kaurërisë. Por Fuqitë e Krishtera, të cilat shqiptarët i trajtuan si lopë apo siç Markezi i San Xhulianos ka thënë se: “shqiptarët nuk janë njerëz aq të kulturuar

sa të vendosin vetë për të ardhmen e tyre" – ju imponuan gjyshërve tanë gërma dhe simbole të krishtërimit.

Rrugës për në Kum ku unë vazhdojë të isha i trullorur nga pamundësia për të lexuar në persisht, mendoja mbi muslimanët shqiptarë të cilët u revoltuan kundër kaurëve të Evropës në 1914. Kryengritja e tyre ndaj imponimit kulturor të krishterë nuk ishte vetëm fetare por ishte edhe një tronditje kulturore apo një 'cultural shock' si ai që po ndjeja unë në natën e thellë iraniane. Gërmat latine për ata ishin po aq të çuditshme sa gërmat persiane për mua. Por unë, përkundrazi nga shqiptarët në 1914 që u çuan në luftë për të ruajtur identitetin e tyre – nuk kisha obsion tjetër por të mësohem me realitetin.

Në Kum arrita në orën 3.40 të natës. Universiteti kishte një konvikt ku mua më çuan të fle në një dhomë me një hoxhë të ri iranian. Edhe pse pak i bezdisur nga kushtet jo shumë të mira, nuk kisha obsion tjetër por të bindem. Ditën tjetër nisa programin mësimor ku sipas planit të kërkuar më parë, nisa të marrë leksione mbi Islamit (që këtu lexohet shiizëm) dhe demokracinë.

* * *

Universiteti Ndërkombëtar i al-Mostafasë ndodhet në zemrën e Kumit. Kum-i për shiitët botërorë është qendra e tyre më e madhe e mësimi, transmetimit të dijes dhe ruajtjes së besnikërisë ndaj imamëve të ehilil bejtit. Pas Kumit, qendra të tjera të rëndësishme për shiizmin botëror janë Naxhafi në Irak dhe Libani. Shiitët e grupacionit ithna'asharia (të dymbëdhjetët) besojnë se në fitnen e madhe që ndodhi në kohën e kalifit Ali, e drejta ishte në anën e Aliut dhe bijve të tij, Hasanit dhe Hyseinin. Edhe sot pas 1300 vjetësh shiitët i qëndrojnë besnikë imamëve shiitë të gjenealogjisë së imam Aliut. Imami i fundit i shiitëve ithna'asharia ka qënë imam Mehdiu i cili sipas shiitëve është fshehur 1200 vite më parë në qytetin e Samarasë në Irak. Ata besojnë se imam Mehdiu është i gjallë dhe sot është 1200 vjeçar por qëndron i fshehur, për të dalë në fundin e kohës, kur fitneja dhe degjenerimi i njerëzimit të ketë marrë përmasa shumë të mëdha. Në Kum shiitët ithna'asharia kanë edhe një xhami të madhe të cilën këta e quajnë Haram ku qëndron e varrosur hazreti Fatimeja, motra e imam Rezasë. Pranë kësaj xhamie shiitët kanë një sërë seminaresh të njohur me emrin Hausa, ku shkollarët e shiizmit vinë nga e gjithë bota dhe mësojnë. Në shiizmin ithna'ashari nxënësit e fesë ndahen në katër kategori. Kategoria e parë janë talebeislamët (nxënësit e fesë), më pas vinë hoxhatelislamët (të diturit e fesë), më pas ajatollahët (të cilët mësojnë dhe japin fetva) dhe në krye të tyre qëndrojnë merxhat apo ajatollahët madhorë - ozman. Në Kum ka rreth 12 merxha, në Na-

xhaf 3, dhe në Liban ka 1. I fundit është Ajatollah Fadlallahu. Fjala e merxhave për besimtarët shiitë është detyrim. Autoriteti i tyre mbi besimtarët është shumë i fuqishëm.

* * *

Ditën tjetër pasi fjeta dhe u çlodha nga rruga, vizitova xhaminë e hazreti Fatime Masumes. Xhamia e cila është me përmasa shumë të mëdha vizitohet nga mijëra shiitë përditë të cilët vinë nga Irani, Iraku, Pakistani, Azia Qendrore, Turqia dhe e gjithë bota. Xhamia në fjalë ishte e mbushur me shumë varre. Të vdekurit e kësaj xhamie varionin që nga hazreti Fatime Masumeja e deri te shehidët modernë të revolucionit islamik të Iranit. Shiitët në këtë xhami bënin dua (lutje) për të vdekurit dhe i kërkonin atyre ndihmë (shefaat). Unë si synit që jam këto sjellje normalisht që më habiti dhe mu duk vetja sikur isha në teqenë e Dervish Hatixhesë në Tiranë apo atë të Hydai Vakfit në Stamboll. Për më tepër më bëri shumë përshtypje që disa të vdekur ishin varrosur në tokë dhe mbi varrin e tyre kishte pllaka ku mund të hecje sipër tyre. Kjo më tmerroi.

I habitur më këto adete të huaja për ne, shoqëruesin tim iranian, e pyeta se përse shiijat i falen varreve. Ai mu përgjigjë që ne nuk i falemi varrit por ne bisedojmë me shehidët pse ata janë të gjallë dhe nuk kanë vdekur. Mua kjo përgjigje më bëri pak skeptik, megjithatë besimin e shiitëve, synitët nuk e kanë ndërruar dot për këto 1400 vitet e fundit; kështu që edhe për mua ishte e kotë të debatoja më tej. Më vonë në biseda që pata me disa shqiptarë në Teheran mësova që shumë shiitë i kërkonin ndihmë të vdekurve. Ata më thanë që kohët e fundit një Mulla paska protestuar kundër këtij riti i cili i largon besimtarët nga adhurimi i Allahut dhe i çon në idhujtari. Këtë gjë ma tha edhe një hoxhë i cili shqetësohej që njerëzit e thjeshtë nuk i falehin Zotit, por të vdekurve.

Miku im shiit me të cilin vizitova xhaminë, nga pyetjet që i bëja e kuptoi që unë jam syni dhe më pyeti se çfarë medhhebi kam. Këtë pyetje ma bënë edhe shumë iranianë të tjerë të cilët e kuptonin nga mënyra e faljeve që nuk isha si ata. Unë të gjithëve ju thoja që jam Islam apo musliman. Pse Islami ka ardhur në këtë dynja para shiizmit dhe synizmit. Nga bisedat që kam patur me miqtë e mi shiitë, kam kuptuar se ata besojnë se shiitët janë besimtarët e vërtetë muslimanë në këtë tokë. Njëri më tha që ne synitët shanim imam Aliun dhe Hyseinin. Unë ja mohova këtë gjë duke i treguar që ne e duam Ehilil Bejtin (familjen e profetit Muhamed) por thjeshtë që fitnen e kohës së Aliut dhe Muavisë e shohin si diçka që i përket të kaluarës. Ama për shiitët e kaluara jeton në të tashmen. Në xhamitë e tyre si psh. në Haramin e Kum-it por edhe në të gjithë Iranin dhe sido-

mos në muajin e Muharremit shiitët shkruajnë me gërma të zeza flamuj si "ja Ali", "ja Hysein", "ja Karbala" etj dhe shprehin besnikërinë e tyre ndaj familjes së Profetit Muhamed. Slloganet si 'ja Hysein Mazllum' (o Hysein i dhunuar) mbushin të gjithë Iranin dhe shkruhen nëpër flamuj të zinj. Përndryshe nga ne synitët që të kaluarën ja kemi lënë të kaluarës, shiitët ithna'asharija pjesë të besimit të tyre kanë vajtimin dhe shprehjen e besnikërisë ndaj Ehilil Bejtit dhe imamëve të tij. Kujtimi i masakrës së Qerbelasë i ndjek besimtarët shiitë kudo në jetën e tyre. Ajatollahët dhe hoxhatelislamët shiitë besnikërinë e tyre fetare e lidhin me këtë të kaluar e cila për ata vazhdon deri në daljen e imamatit të fshehur. Për shiitët tradicionalë ne synitët perceptohemi si mëkatarë dhe tradhëtarë të Ehilil Bejtit.

Megjithatë jo të gjithë shiitët mendojnë si shiitët ithna'asharija. Gjatë qëndrimit tim në Universitetin e al-Mustafasë takova një shiit ismaili nga Pakistani. Këtë e takova në xhaminë Xhamkeran në dalje të Kum-it – të cilën shiitët ithna'asharija mendojnë se është ndërtuar me urdhër nga imam Mehdiu i cili i ka dalë në ëndër një besimtari në shekullin e 19të. Për shiitin ismaili, këta lloje shiitësh nuk vajtojnë për imam Hyseinin dhe as nuk presin imam Mehdiun si ithna'asharijat, pasi për ata, imamati vazhdon deri në ditët tona nëpërmjet linjës së imamëve ismailitë që sot përfaqësohen nga Aga Khani. Aga Khani sot jeton në Francë, ka një seri fondacionesh dhe organizatash dhe që aty drejton shiitët ismailitë.

* * *

Fakti që e bën Iranin një nga vendet më interesante të botës islamike nuk është shiizmi, dhe interpretimi jo-traditional i islamit, i cili gjendet në shumë anë të globit; por është Revolucioni Islamik i Iranit. Revolucioni Islamik i Iranit që ndodhi në vitin 1979 ka tronditur rëndë shiizmin tradicional dhe të gjithë botën e Islamit. Kur imam Khomeini erdhi në pushtet pas revoltës popullore në Iran kundër pushtetit të Shahut, shiitët ithna'asharija u pajisën me një shtet që drejtohet nga mullahë dhe ajatollahë. Edhe pse në të kaluarën në Iran ka pasur një seri dinastishë shiite, ku më e spikatura është ajo e safavidëve e cila edhe imponoi shiizmin në vend kundër synizmit, Revolucioni Islamik i Iranit ka tronditur rëndë dogmën shiite e cila që prej 1200 vitesh ishte mësuar të jetë në opozitë ndaj çdo regjimi dhe presë ardhjen e imamatit të fshehur. Krijimi i Republikës Islamike të Iranit erdhi për botën shiite sa si shtet aq edhe si tronditje. Imam Khomeini, rehberi (udhëheqësi) i Republikës Islamike përpara fitores së revolucionit nuk ka menduar ndonjëherë, që një ditë, shiitët do të bëheshin drejtues

të një supershteti si Irani. Arsyeja pse populli iranian u rebelua kundër Shahut në vitet 1970 ishte se ky ishte bërë vegël e amerikanëve, dhe iranianët trajtoheshin si kafshë nga regjimi i asaj kohe. Në vitet 70-të si pasojë e krizës ekonomike botërore dhe rënies së çmimit të naftës, klasa punëtore iraniane dhe populli u revoltua kundër pushtetit të Shahut. Në revoltë mori pjesë klasa punëtore, revolucionarët komunistë dhe më në fund edhe vetë ajatollahët dhe besimtarët shiitë. Shahu i cili komandohej nga amerikanët, arriti deri aty sa të laicizojë vendin dhe përjashtojë Islamit si fe zyrtare të Iranit dhe të shpikë mitet e Persisë së Lashtë dhe Dariusit të Madh si idhuj modernë të laicizimit dhe perëndimorizimit të vendit. Përjashtimi i Islamit nga identiteti i njerëzve dhe imponimi i miteve persiane është një shembull që ne gjejmë që perëndimorët kanë zbatuar në shumë vende muslimane. Ne në Shqipëri psh. në këto ditë po dëshmojmë ende luftën që mitet e Skënderbeut dhe ilirëve dhe pellazgëve dhe slloganet tip "feja e shqiptarit asht shqiptaria" bëjnë me identitetet globalizuese të Shqipërisë pas-komuniste. Por në Iranin e viteve 1970, shpikja e "skënderbejve dhe persianëve antikë" për të përjashtuar Zotin nga identiteti kombëtar iranian, nxiti revoltën e hoxhallarëve dhe intelektualëve iranianë si Ali Sheriati të cilën nuk mund të pranonin këtë poshtërim.

Por me fitoren e revolucionit islamik, shiitët e Iranit, për herë të parë në historinë e shiizmit botëror u gjendën në dilemë të madhe; dilemën e pushtetit. Shiitët kanë organizuar disa revolucione në historinë e Islamit, që nga revolucioni abasid e deri te ai fatimid. Megjithatë abasidët u sunitizuan shpejt pasi erdhën në pushtet, ndërsa fatimidët e Egjiptit ishin shiitë ismailitë. Por për më tepër, revolucioni islamik i shiitëve të Iranit ndodhi në kohët moderne, kur tashmë shteti nëpërmjet edukimit masiv, centralizimit të pushtetit, modernizimit të vendit etj identitetin e tij e imponon shumë më fuqishëm sesa bënë kalifatet islamike në kohët e arta të Islamit. Personat që bënë revolucionin islamik të Iranit ishin komunistë, socialistë dhe islamistë dhe hoxhallarë të cilët kishin vuajtur rëndë nga shtypja e Shahut dhe amerikanëve. Por pas fitores së revolucionit frenat e pushtetit i morën hoxhallarët. Imam Khomeini i cili përpara revolucionit nuk kishte menduar që do të bëhej me shtet, tashmë, u përball me dilemën e madhe; të ja linin shtetin komunistëve aftarë apo ta mbanin vetë? Ta lejonin Iranin që të qeverisej nga një Sadam Husein apo nga ata? Mullahët revolucionarë përqaftuan idenë e fundit dhe Republikën Islamike të Iranit e ndërtuan si një shtet islamik.

Megjithatë problemi i shiizmit me Republikën e Iranit qëndron në faktin e legjitimitetit teologjik të këtij

realiteti. Sipas shkollarëve tradicional shiitë, shiitët duhet të durojnë padrejtësitë deri sa të vijë imami i fshehur. Por ajo që imam Khomeini bëri, shkon përkundër mësimëve tradicionale shiite. Imam Khomeini për shiitët erdhi tamam siç erdhi Jezu Krishti për farisejtë dhe saducejtë çifutë, me reforma ndaj ligjit të vjetër të fesë. Për këtë arsye shiitët e sotëm janë në një dilemë aq të madhe mbi shtetin e tyre, sa ishin çifutët në kohën e ardhjes së Krishtit. Rabinët çifutë prisnin ardhjen e Mesisë, ama kur ai erdhi, këta thanë që ky nuk është Krishti por një mashtrues. E njëjta gjë ndodh edhe në Iran. Një grup i madh ajatollahësh tradicionalë shiitë e refuzojnë konceptin e Republikës Islamike të Iranit dhe pushtetin e fakihut (vilajetin e Fakihut) që imam Khomeini përdori për të legjitimuar fetarisht krijimin e RI të Iranit dhe presin fundit e dynjasë kur të shfaqet Imam Mehdiu. Sipas shumë shkollarësh shiitë Vilajeti i Fakihut është një bidat dhe mëkat aq i madh sa është edhe kalifati i Ebu Bekrit, Umarit dhe Osmanit pas Profetit Muhamed. Si rjedhojë sot në Iran dhe në botën e shiizmit, shiitët janë të ndarë në dy grupe kryesore; një palë i gëzohet ekzistencës së Iranit si shtet shiit. Ndërsa pala tjetër – ashtu si çifutët që janë kundër shtetit të Izraelit – nuk e pranojnë krijimin e tij mbi baza teologjike.

Shumë ajatollahë, hoxhatelislamë dhe merxha (krye-ajatollahë), si psh. Ajatollah Sistani i Irakut, Fadlallah i Libanit dhe Vahid Khorasani i Kunit, refuzojnë të pranojnë republikën e sotme si fetarisht korrekt. Disa të tjerë abstenojnë. Ndërsa disa të tjerë mallkojnë mullahët dhe ajatollahët që janë bërë pjesë e qeverisë së Republikës Islamike dhe thonë që rroga që ata marrin dhe puna që ata bëjnë është harram. Shumë të tjerë akuzojnë mullahët që mbajnë shtetin iranian se janë konvertuar në synitë.

* * *

Dilema e Republikës Islamike të Iranit për të legjitimuar veten e saj fetarisht ka marrë përgjigje me përdorimin e pan-islamizimit. Kur dikush viziton Teheranin sheh që shumë rrugë të kryeqytetit iranian kanë emra reformatorësh synitë. Kështu dikush sheh në Iran rrugën Hasan Al Benna, Seid Kutub etj. Nëpër rrugët e Iranit lufta e palestinezëve në Gaza shoqërohet me postera të mëdhenjë ku tregohet ose gjaku i palestinezëve synitë ose Rehberi i Republikës Islamike, Ajatollah Khamenei duke u përqaftuar me shefin e Hamasit, Khalid Meshaal. Diku më tej kur dikush shkon në sheshin e Palestinës, sheh një përmendore në bronx të herojve palestinezë që luftojnë kundër Izraelit dhe piktura murale ku palestinezët portretizohen në pozicione heroike, si Vojo Kushi dhe partizanët që portretizoheshin te ne në Shqipëri në kohë të komuniz-

mit. Nëpër publikimet iraniane, revolucionin islamik i Iranit tregohet si kulminuesi i lëvizjeve revolucionare në botën islame kundër kolonializmit kristian, të cilat nisin në kohën e sulltan Abdylhamitit me Xhemaludin Afganin (që këta e iranianojnë dhe e quajnë Asadabadi), vazhdojnë me Hasan al-Benën dhe Seid Kutubin dhe kulminojnë me revolucionin e Imam Khomeinit. Në ditët e para kur mbërrita në Iran pashë që gazetaret vendase buçisnin me lavdet e tyre për kryeministrin Erdogan i cili ofendoi në Davos kryeministrin Izraelit. Kryebashkiaku i Teheranit e shpalli sadrazemin tonë turk, qytetar nderi.

Lidhja që shiitët revolucionarë i bëjnë revolucionit të tyre me lëvizjet në botën synite, kuptohet qartë kur dikush flet me intelektualë iranianë në Teheran. Me njërin që unë pata rastin të bisedojë gjatë, ky më ankohej pse shiitët nuk falen aq shumë sa sunitët, pse sunitët janë më fetarë se shiitët dhe frekuentojnë më shpesh xhamitë etj. Unë ju përgjigja me të qeshur, që ju duhet të bëheni synitë, pse ne synitët kemi 1400 vite histori qytetërimi në shpinë dhe e dimë më mirë sesi punon feja. Abstenimi që shumë shiitë i bëjnë namazit të xhumasë, mos falja e namazeve në kohë (por bashkimi i tyre në tre namaze), ndikojnë shumë në identitetin fetar të njerëzisë. Kushdo që ka vizituar Turqinë, Arabinë Saudite dhe shumë vende të tjera dhe i krahason këto me Iranin arrin në konkluzion që populli në Iran është më pak fetar sesa turqit dhe arabët. Ky konkluzion për dikë mund të jetë paksa i nxituar, por për mua, demonstrimi i fesë që bëhet nga synitët gjatë faljes së xhumasë tregon masivitetin e fetarizmit të tyre.

Por edhe pse zyrtarisht Irani e portretizon veten e tij si kampion të lëvizjeve anti-kolonialiste në botën e islamit, në Teheran por edhe në të gjithë Iranin synitët nuk gjejnë trajtimin që kanë shiitët. Në Teheran për shembull synitët nuk kanë asnjë xhami synite por vetëm disa mesxhide. Një iranian të cilin e pyeta pse nuk i lejoni synitët të kenë xhamitë e tyre në Teheran (siç kanë në provincat synite) ai më tha: “eh ... ne shiitët jemi bërë si zionistët. Ne besojmë se vetëm ne jemi në fenë e drejtë, ndërsa të gjithë të tjerët janë në të gabuarën.” Ndërsa një tjetër më tha “po edhe në vendet arabe shiitët persekutohen.” Por për mendimin tim, arsyeja pse në Teheran synitët nuk lejohen të hapin xhami lidhet me tensionin e brendshëm politik që ekziston në Iran ndërmjet revolucionarëve shiitë dhe inteligjencës së Teheranit e cila është më e hapur ndaj botës synite, dhe konservatorëve shiitë të Kunit të cilët në shumë raste – siç ishte rasti kur presidenti Ahmetinexhat kërkoi të lejohet vajzat që të shkojnë në stadium – akuzojnë pushtetarët për herezi dhe filosynizëm.

* * *

Gjatë vizitës time 12 ditore në Iran e kam ndjerë veten shumë të turbullt dhe më dukej sikur isha në ëndër. Arsyeja është se në Iran çdogjë apo ndoshta shumëgjë është ndryshe nga bota ku ne jetojmë dhe jemi mësuar të rrimë. Iranianëve më të cilët bisedoja, ju tregoja që mua Irani më duket sikur ekziston në një planet tjetër. Në Iran mullahët dhe ajatollahët drejtojnë çdogjë. Ata drejtojnë shkolla, universitete, bile deri në fabrika që prodhojnë makina. Ditët e javës këtu ecin sipas modës islamike, ku e enjtja dhe e premtja janë pushim kurse e shtuna dhe e djela janë ditët e para të javës. Në Iran viti është 1387, muaji ishte bahman, kalendari që këta përdorin është shemi (diellor) si romaku që ne përdorim, por siç këta thonë është shpikur nga Omar Khajami dhe jo nga Augusti romak dhe ka 622 vite diferencë me perëndimorin. Në Iran, shteti ka futur islamit në çdo aspekt të jetës. Në shkolla, në uzina, në fabrika, në rrugë, në autostrada, në aeroporte, në gazeta, libra etj nga do që të kthehesh sheh islam. Në rrugën Kum – Teheran psh. dikush lexon të shkruar nëpër malet e shkretëtirës që lidhin dy qytetet bashkë sllogane masive si “La ilaha il Allah”, “Muhamedur Resulullah”, “Ali Velijullah”, “SubhanAllah”. Kur shkon nëpër universitete sheh ngado nëpër programet e tyre lëndë islame. Në gazetaret e vendit edhe pozita edhe opozita sulmohen dhe mbrohen me islam. Pastaj nëpër rrugë dikush sheh vetëm posterë të Ajatollah Khomeinit dhe Khameneit dhe klerikëve të tjerë shiitë, si Shehid Mutahari etj.

Ne muslimanët apo ndoshta ish-muslimanët që rrojmë në Evropë jemi mësuar që posterat tanë ti zënë ose femrat që reklamojnë mallra dhe thonë “catch my beast”, ose fytyrat e Berluskonëve dhe “Berishës më duar të pastra”, ose halabakëve si Edi Rama që janë kukulla të ambasadeve perëndimore, apo në kohë të PPSH-së unë mbaj mend që shihja postera të Marksit, Engelsit, Leninin dhe Stalinit. Kohët e fundit ne kemi parë shpesh edhe postera si psh. “welcome president Bush” apo “dhjetë vite pa dhe dhjetë ditë me Nënë Terezën”. Por që ndonjëherë do të shihja në jetën time postera me hoxhallarë me mjekra që mallkojnë imperializmin dhe Amerikën unë këtë kurrë nuk e kam imagjinuar ndonjëherë. Këta imamë të frikshëm dhe hijerëndë që inspirojnë revolucionarët iranianë kundër imperia- lizmit për mua krijonin një “shock” shumë të thellë ndaj gjithëçka që unë jam mësuar të mendoj deri më tani. Imamët e revolucionit islamik iranian janë një miksje ndërmjet nacionalizmit, modernizmit, të shenjtës, shekullares dhe islamizmit, të cilin unë e kam pak të vështirë ta perceptoj sesi funksionon. Nga që unë vija nga një planet tjetër, ndërthurja e të shenjtës me tokësoren me bënte shu-

më konfuz.

Irani duket që i përket një planeti tjetër edhe nga mënyra e jetesës. Vendi është jashtëzakonisht i pasur, por edhe i shkretë. Rruga psh. përreth Teheranit, Kunit, aeroportit Imam Khomeini etj janë shkretëtirë. Qyteti i Kunit psh është i rrethuar nga një shkretëtirë e frikshme. Toka e shkretëtirës ka kripë dhe si pasojë edhe uji i Kunit është i papishëm dhe me kripë. Kur shihja këtë shkretëtirë e cila i ngjan asaj të Arabisë Saudite unë pyesja veten sesi është e mundur që raca njerëzore jeton këtu? Por ndërsa dikush sheh shkretëtirën përfaqë, kur hyn në qytete, si psh në Teheran i cili në disa lagje duket shumë më i pasur edhe sesa shumë lagje të Evropës, dikush habitet dhe pyet se nga vjen gjithë kjo pasuri? Ndërsa në Evropë dhe Shqipëri kohët e fundit ka pllakosur kriza, qendrat komerciale të Teheranit gati sa nuk çahen nga numri i madh i blerësve. Në anën tjetër çmimet e shumë shërbimeve dhe produkteve në Iran janë tmerrësisht të lira. Kështu psh. një litër benzinë kushton rreth 10 cent dollari apo 10 lekë të reja shqiptare, ndërsa në Shqipëri dhe Evropë litri shkon te rreth 1.50 EURO. Lirësia shihet edhe në çmimin e rrobave të cilat janë gjysma apo edhe më shumë e atyre që ne kemi në Ballkan, të çmimit e shërbimeve telefonike, transporti publik etj. Si pasojë e çmimit të ulët të benzinës dhe mungesës së transportit të mirë publik, rrugët vlojnë nga makina private dhe motorë, të cilët krijojnë një trafik të llastarshëm, shumë zhurmë dhe ndosin ajrin shumë.

* * *

Në Iran prej disa vitesh jetojnë edhe disa shqiptarë nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia. Disa prej tyre janë synitë. Disa të tjerë jofetarë. Ata kanë ardhur për shkolla këtu në mënyrë private, nga bektashitë dhe organizata të ndryshme dhe tashmë kanë ngelur në Teheran ndërsa përjetojnë luksin ekonomik të vendit. Disa prej tyre që punonin për IRIB-in gëzonin një jetë për tu patur zili, të cilën shqiptarët në perëndim nuk e arrijnë kurrë. Megjithatë të shkretët shqiptarë që takova mu qanë për kërcënimet që marrin nga organet e sigurisë në vendet e tyre, të cilat për sa herë që këta shkojnë në atdhe i kërcënojnë pse jetojnë dhe punojnë në Iran. Kur gazetarët në fjalë më tregonin për llojet e kërcënimeve që marrin në vendet e tyre në Ballkan – nisa të mendoj për trajtimin që marrin në vendet tona gazetarët e Zërit të Amerikës. Këta të fundit edhe pse shpesh thonë njëmijë horllëqe dhe i bëjnë iso Ismail Kadaresë, Dom Lush Gjergjit etj që kërkohen të kaurizojnë me dhunë dhe poshtërojnë shqiptarët; në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni priten sikur të jenë komandantë çlirues nga Amerika. Kurse djemtë dhe vajzat e pafaj që punonin

në Teheran për IRIB-in kërcënohen sikur të jenë kriminelë dhe jo gazetarë. Gazetarët e IRIB-it ishin aq të frikësuar nga organet policore në Ballkan sa që më kërkuan që në përshtypjet e mia që do bëja për Iranin emrat e tyre ti mbaj sekret. Ndër të tjera ata edhe më pyetën sesi guxoja unë, dhe si është e mundur që jam ende gjallë kur në shkrimet e mia (të cilat ata i lexonin shpesh) e kam bërë për adet që një e dy të shajë Amerikën. Pasi i futa një kompliment labçe Bushit dhe Amerikës, i kurajova që të mos kenë frikë, por të bëhen guximtarë dhe besimtarë në demokraci dhe fjalën e lirë, edhe nëse spiunërit i kërcënojnë dhe kërkojnë që t'i heshtin me çdo mënyrë. Kaderi ynë qëndron në dorë të Allahut dhe jo të spiunëve dhe vagabondëve të Amerikës në Ballkan. Dhe për më tepër Evropa në të cilën ne jetojmë është një kontinent i demokracisë dhe fjalës së lirë.

* * *

Në Iran shteti është republikë dhe pretendon të funksionojë si një demokraci teokratike. Me disa intelektualë iranianë me të cilët debatova konceptet e demokracisë ata më thanë që ata nuk besojnë në humanizëm dhe në vlerat perëndimore. Disa filozofë, Iranin e shohin si një utopi islamike sipas shembullit të Shën Akunit të qytetit të Zotit. Sipas mullahëve - filozofë të Republikës Islamike, shteti që këta kërkojnë të ndërtojnë synon që të prodhojë njeriun perfekt (insan al-kamil) i cili do të ndërtohet nga republika islamike dhe finalizohet në perfeksionin me ardhjen e imamit të fshehur, imam Mehdiut. Për këtë arsye pushteti në Iran imponon Islamit mbi popull - duke futur këtu veshjen e detyrueshme të shamisë (të cilën unë e refuzoj si absurde dhe që shkon kundër mësimin islam), mësimin e islamit nëpër shkollë, fabrika dhe në të gjitha hapësirat publike të Republikës. Megjithatë nga vizitat e mia në Teheran unë besoj se mullahët po dështojnë tmerrsisht me islamizimin e popullit të tyre. Në kundërshtim me hoxhallarët tanë synitë që që nga Shqipëria e deri në Indonezi janë popull i thjeshtë dhe fukara dhe punojnë me popullin në bazë, vuajnë me ata dhe gëzojnë me ata, hoxhallarët iranianë të llastuar nga pushteti që kanë marrë pas revolucionit, rrinin nëpër zyra dhe mendonin se populli mund të islamizohet me ligje dhe me imponime nga lartë. Gjendja e inteligjencës dhe popullit në Teheran mua më krijonte një Deja Vu ndërmjet kohës së Abdylhamitit II; kur në Stamboll sulltani i mirë turk mudohej të edukonte popullin me islam që nga lartë, dhe në anën tjetër të realitetit osman nëpër shkollë dhe rrugë ku hoxhallarët mungonin për të përçarur dëshirën e sulltanit dhe në anën tjetër ishin freemasonët xhon turq ata të cilët kishin konver-

tuar pjesë të mëdha të shoqërisë të besojnë që sulltani ishte tiran dhe islami i dëmshëm. Situata e Iranit sot i ngjan shumë perandorisë në ditët e fundit të Abdylhamitit. Në universitetet iraniane ka një rebelim të fortë kundër pushtetit të mullahëve. Intelektualë iranianë si Soroush, Mohsen Kadivar etj nëpër universitetet e vendit sulmojnë mullahët dhe utopinë e tyre dhe kërkojnë liberalizimin e vendit. Për këtë ata mbështeten fuqishëm nga bursa dhe të drejta studimi që u ofrohen nga Perëndimi, ndërsa në vend opozita kundër pushtetit të mullahëve përfaqësohet nga grupi i ish-presidentit Muhamed Khatami i cili kërkon të ndryshojë natyrën e shtetit të ndërtuar nga imam Khomeini.

Gjithësesi për sa i përket natyrës së pushtetit, në ndryshim me ne synitë që besojmë në sulltanat dhe kalifat, ku më i devotshmi apo i forti mund të marrë pushtetin, shiitët besojnë se sunduesi duhet të zgjidhet vetëm nga imamët shiitë. Teologjia që imam Khomeini zhvilloi përpara bërjes së revolucionit islamik në Iran është që ndërsa në botë imam Mehdiu rri i fshehur, atëherë është detyrë e fukahave (juristëve të ligjit islam) që të kalojnë kufijtë e tyre tradicional (ku këta merren me çështje civile, si martesë, dënime etj) dhe fukahai të bëhet edhe drejtues i shtetit. Khomeini zhvilloi konceptin e Vilayah Mutlaka al Fakihut apo pushtetit total të fakihut. Me këtë ide ai ndërtoi institucionet e Republikës Islamike të Iranit.

RI e Iranit funksionon pak a shumë si një republikë parlamentare. Në krye të shtetit qëndron Rehberi (udhëheqësi apo imami) i cili zgjidhet nga këshilli i fukahave. Poshtë tij qëndron presidenti i cili zgjidhet nga populli por që në fakt drejton qeverinë dhe sillet si kryeministër i republikës parlamentare. Qendër tjetër autoriteti është parlamenti (mexhilisi shura) i cili zgjidhet nga populli dhe aprovon ministrat e presidentit. Përveç këtyre republikës ka edhe disa organizma të tjerë, si psh. Këshilli i Rojeve që përbëhet nga 6 fukaha dhe 6 juristë dhe mbi të gjitha Asambleja e Ekspertëve e cila zgjedh përplasjet ndërmjet presidentit dhe parlamentit. Por në Iran parlamentarët nuk mund të jenë njerëz dosido. Këta duhet të aprovohen më parë nga fukahatë për vlerat e tyre islamike, përpara se të kandidojnë si deputetë në parlament. Me pak fjalë Irani mund të definohet si një republikë demokratike ku pushtetin e kanë mullahët dhe njerëzit që dëshmojnë besueshmëri ndaj vlerave islamo-shiite.

* * *

Gjatë qëndrimit tim rreth 12 ditore në Iran unë vizitova një seri institucionesh të "besimit civil" të Republikës Islamike të Iranit. Këtu sjell ndërmend mazoleumin e imam Kho-

meinit në Beheshti Zahra, Haramin e Kum-it ku në hyrje të tij qëndronin portrete të rehberëve të Republikës Islamike, varrezat e dëshmorëve kombëtarë iranianë gjatë luftës Iran - Irak dhe normalisht që në ditën e parafundit të qëndrimit tim në Iran, shkova në qytetin e studentëve të Teheranit për të falur namazin e xhumasë.

Namazi i Xhumasë për shiitët iranianë nuk është farz (i detyrueshëm) siç e kemi ne synitët. Për ata xhumaja është namaz politik, i cili, deri në kohën e shfaqjes së imam Mehdiut nuk është i obligueshëm por opsional. Megjithatë kureshtja që kisha për të parë faljen e xhumasë shiite më çoi që në 13 shkurt, ditën e premte të shkojë në qytetin e studentëve të Teheranit për të parë sesi falet xhumaja. Këtu duhet të pranojë që më habiti fakti se xhumaja falej në një shesh shumë të madh, dhe për më tepër falja nuk bëhej siç bëhet nga ne synitët ku hoxha flet dhe populli dëgjon. Këtu besimtarët kishin një interaksion me hytbe mbajtësin, ku sa herë që ai përmendte emrin e Profetit Muhamed populli binte në salavat me zë të lartë; apo kur imami shante imperialistët amerikanë, populli brohoriste me grushtin në formë goditëse me slogane tip: Merg Ber Amerika, Merg Ber Israil, Merg Ber Inglis (vdekje Amerikës, vdekje Izraelit, vdekje Anglisë). Edhe pse ne fytyrat e shume brohoritësve unë shihja të qeshura, që tregon se ata nuk i kishin përnjëmend deklaratat e tyre, sërisht deklaratat e tyre ishin shumë serioze dhe kur sjell nëpërmend dobësinë e Iranit përpara Amerikës, deklaratat në fjalë më dukeshin të dëmshme për fraxhilitetin e Republikës Islamike.

Një nga temat kryesore të xhumasë në të cilën unë mora pjesë ishte edhe zhvillimi teknologjik i Iranit. Në ditët kur unë isha në Iran, iranianët përkujtuan 30 vjetorin e revolucionit të tyre kundër Shahut. Këtu edhe pse pjesë të mira të popullit nuk e pëlqejnë regjimin aktual, për çudinë time, ditën e revolucionit rrugët u mbushën me mijëra njerëz - besimtarë dhe laikë - të cilët përkujtonin fitoren e 30 viteve më parë. Në ditën e revolucionit por edhe në xhumanë në fjalë, iranianët i gëzoheshin faktit që disa ditë më parë këta kishin lëshuar në hapësirë një satelit të bërë nga vetë iranianët të quajtur Omid - Shpresë. Siç edhe fjala Shpresë tregon, për iranianët progresi teknologjik sidomos në fushën ushtarake shihet si shpresa e vetme që Republika Islamike e Iranit ka për të ruajtur pavarësinë e vendit të tyre dhe mospërfundimin e Iranit në një shtet kukull siç janë vendet e tjera të Gjirit Persik. Kjo temë përsëritej në pjesën e dytë të xhumasë që unë dëgjova. Duke qenë se Irani sot jeton nën një seri embargo dhe sulmesh ideologjike nga perëndimi, mentaliteti i rrethimit që mbizotëron në mendjen e drejtuesëve të RI të Ira-

nit i shtyn këta që të bëjnë çdo gjë që është në mundësinë e tyre që të sigurojnë mbijetesën e republikës.

* * *

Qëndrimit tim 12 ditore në Iran i erdhi fundi në datë 14 shkurt 2009. Natën e ditës vijuese pasi qëndrova në Teheran me miqtë e mi shqiptarë, mora sërisht Turkish Airlinesin dhe me atë u ktheva sërisht në Stamboll nga ku do të lidhesha më pas me linjën e Tiranës për të ardhur në Shqipëri. Ndërsa isha në Stamboll, unë ndoqa ritualin tim të zakonshëm. Piva çaj buzë Bosforit, dhe më pas takova disa hoxhallarë nga Shqipëria dhe Maqedonia të cilët kishin marrë pjesë në një konferencë për Gazën. Me këta të Shqipërisë, mora rrugën për në Tiranë. Kur mbërritëm në aeroportin Nënë Tereza në Tiranë, murgeshë Tereza që si duket ishte bërë xhind nga xhelozia me kureshtjen time për të vizituar vendin e hoxhë Khomeinit, në Rinas na kishte çuar rreth 5 zabitë dhe hafije të drejtuar nga Ervin Dalipi të cilët sapo ne dolëm në tokën shqiptare na shoqëruan për në stacionin e policisë të Rinasit, ku aty na zbrëthyen çantat dhe xhepat dhe rrobat e trupit për të parë se mos kishim sjellë ndonjë imam apo sulltan apo helbete ndonjë nga ato bumjet e Ahmetinexhatit nga Irani, për të cilat nuk i zë gjumi kaurët e Amerikës. Dilemat dhe fobitë që unë kisha përpara vizitës sime për të vizituar "Boshtin e të keqes" provuan të ishin të vërteta. Në boshtin e poshtërsisë ku sundojnë mullahët e krishterë të Perandorisë Amerikane, ne shqiptarët duhet ti nënshtrohemi kontrolleve policore nga kalecët shqipfolës që i shërbejnë lepe dhe peqe vëllait tonë të madh judeo - kristian. Kalecët e Rinasit që siç duket ishin njoftuar mbi mbërritjen tonë nga "Boshti i së keqes" kohë më parë, na pritën në Rinas në mënyrë kërcënuese dhe vigjëlente, si për të na treguar që këtu në Shqipëri, kulaçin dhe kërbacin nuk e kontrollojnë hoxhallarët dhe ajatollahët e tmerrshëm si në Iranin e largët dhe as sulltanët e Bosforit, por nënëterezistët e krishterimit amerikan. Duke qenë koshient i tiranisë kristjane që ekziston në vatanin tim, unë bashkëpunova bindshëm me hyzmetqarët e vëllait tonë të madh. Hapa xhepat dhe çantat për ti provuar hafijeve të vëllait të madh që në Boshtin e të Keqes isha thjeshtë si vizitor kureshtar dhe tani pas ardhjes në Boshtin e Poshtërsisë isha i gatshëm që si një dhimi i bindur ti bindem tiranisë së vëllait të madh.

T'u rritë jeta o vëlla i madh që na ruan nga Boshti i të Keqes ditë e natë! Pa ty do të na kishte shuar fare. T'u bëftë dita një mijë ja Rabi!

HISTORIA E PALESTINES

Palestina e në veçanti Jerusalemi, në zemrën e saj, që nga fillimi i historisë së Islamit, ka qenë e shenjtë për myslimanët.

Shikimi i Palestinës nga ana e myslimanëve si vend hyjnor ua ka bërë atyre të mundur që rajonit t'i sjellin paqe dhe harmoni. Ekzistojnë dy arsye themelore pse Jerusalemi është vend i shenjtë për myslimanët: Ai ishte drejtimi i parë nga i cili myslimanët ktheheshin për t'u falur. Veç kësaj, e ç'ka mund të shihet edhe si një ndër mrekullitë më të mëdha të Profetit Muhamedit, ngjitja e tij në qiell, ishte nga Meshxhid al-Haram deri tek Mesxhid al-Aksa, që do të thote nga Meka në Jerusalem. Ky fakt është shpallur në Kuran në këtë mënyrë: Pa të meta është Lartmadhëria e Atij që robin e vet e kaloi në një pjesë të natës prej Mesxhidi Haramit (prej Qabes) gjerë në Mesxhidi Aksa (Bejti Mukaddes), rrethinën e të cilës Ne e kemi bekuar, (ia bëjmë këtë udhëtim) për t'ia treguar atij disa nga argumentet Tona. Vërtet, Ai është dëgjuesi (i fjalëve të Muhamedit), pamësi (i punëve të Muhamedit). (Sure al-Isra: 1) Në tregimet Kurane rreth Profetit, në ajetet të cilat flasin lidhur me tokën e Palestinës ata u referohen si 'toka të bekuara' dhe 'toka të shenjtë'. Në ajetin e lartshënuar rreth ngritjes në qiell, Mesxhidi al-Aska është përshkruar si një tokë 'rrethinën e të cilës Ne e kemi bekuar.' Në suren Al-Enbija, ku është rrëfyer për migrimin e profetëve Ibrahim dhe Lut, ku territori i njëjtë është përshkruar si 'një tokë që Ne e kemi bekuar.' E tërë toka e Palestinës, ku shumë profet nga fisi Izraelit kanë jetuar dhe luftuar në rrugën e Zotit dhe ku kanë rënë dëshmorë apo vdekur dhe varrosur, është i shenjtë për myslimanët. Si pasojë, myslimanët kanë sjellë lumturi, paqe dhe siguri në Jerusalem dhe Palestinë për më shumë 1,400 vjet.

PAQJA DHE DREJTËSIA QË I SOLLI PALESTINËS KALIFI OMER

Jerusalemi ishte kryeqyteti i çifutëve deri në vitin 71 p.e.s. Në atë vit ushtria romake u lëshua sulmii çifutët dhe i përzuri ata nga zona pas një egërsie të paparë. Pasi nisi koha e diasporës çifute, Jerusalemi dhe zona për rreth e tij po shndërroheshin në një vend të braktisur. Sidoqoftë, Jerusalemi u bë përsëri qendër interesash me pranimin e Krishterimit në kohën e perandorit romak Kostandin. Të krishterët romakë ngritën kisha në Jerusalem. Ndalimet ndaj çifutëve për t'u vendosur në atë zonë u hoqën. Palestina mbeti territor romak (bizantin) deri në shekullin e 7-të. Persët e pushtuan rajonin për një kohë të shkurtër, por më pas bizantinët e rimorën atë. Një pikë e rëndësishme kthese në historinë e Palestinës ndodhi në vitin 637, kur ajo u mor nën kontroll nga ushtritë e Islamit. Kjo nënkuptonte lindjen e një periudhe paqeje dhe harmonie në Palestinën që kishte qenë për shekuj skena e luftërave, shpërnguljeve, grabitjes dhe masakrave dhe që kishte njohur vrazhdësinë gjithnjë me ndryshimet e shpeshta të qeverisjeve. Ardha e Islamit përbënte nisjen e një epike të re, kur njerëzit e besimeve të ndryshme në Palestinë, do të mund të jetonin në paqe e harmoni. Palestina u mor

nga Omeri, kalifi i dytë pas vetë Profetit. Hyrja e Omerit në Jerusalem, toleranca e jashtëzakonshme, pjekuria dhe urtësia që ai tregoi ndaj njerëzve të besimeve të ndryshme, paraqisnin fillimin e epokës së bukur që po niste. Historiana britanike dhe specialistja e çështjeve të Lindjes së Mesme, Karen Armstrong, në librin e saj "Lufta e Shenjtë" marrjen e Jerusalemit nga Omeri, e përshkruan kështu: Kalifi Omer hyri në Jerusalem hipur mbi një deve të bardhë, i shoqëruar nga një magjistrat (zyrtar) i qytetit, patriarku grek Sofroni. Kalifi kërkoi të dërgohej menjëherë në Malin e Tempullit dhe u përul në lutje në vendin ku shoku i tij, Profeti Muhamed kishte kryer Udhëtimin e tij të Natës. Patriarku pa i tmerruar: Kjo, mendoi ai, duhej të ishte përbaltja e shkretisë që profeti Daniel kishte parathënë se do të hynte në tempull. Ky duhet të jetë Antikrishti që do të lajmërojë afrimin e Ditëve të Fundit. Pastaj Omeri kërkoi të shihet faltoret e krishtera dhe ndërsa ishte në Kishën e Varrit të Shenjtë, koha për lutjet myslimane ishte afuar. Patriarku e ftoi atë me mirësjellje që të falej aty ku ishte, por Omeri kundërshtoi me të njëjtën mirësjellje. Nëse ai do të përulë për t'u falur në kishë, shpjegoi ai, myslimanët do të dëshironin të nderonin kujtimin e kësaj ngjarjeje duke ngritur aty një xhami dhe kjo do të thoshte se ata do të duhej ta prishnin Varrin e Shenjtë. Në vend të kësaj, Omeri shkoi të lutej pak më larg se kisha dhe në drejtim të kundërt me Varrin e Shenjtë ku edhe sot gjendet një xhami e vogël, kush-tuar kalifit Omer. Xhamia tjetër e madhe e Omerit u ngrit në Malin e Tempullit për të shënuar çlirimin mysliman, bashkë me xhaminë Aksa, e cila përkujton Udhëtimin e Natës të Muhamedit. Për vite të tëra, të krishterët kishin përdorur anën e tempullit të shkatërruar çifut për të mbledhur mbeturinat e qytetit. Kalifi ndihmoi me duart e veta myslimanët që të pastronin plehrat dhe myslimanët aty ngritën dy faltore për të vendosur Islamin në qytetin e tretë më të shenjtë në botën islame. Myslimanëtishin ata që i sole 'qytetërimin' Jerusalemit dhe të gjithë Palestinës. Në vend të besimeve të egra që nuk tregonin respekt për vlerat e shenjtë të njerëzve të tjerë dhe që i vrisnin ata vetëm për shkak të ndryshimeve në bindjet fetare, aty mbretëroi drejtësia, toleranca dhe kultura e moderuar e Islamit. Pas marrjes së Palestinës nga Omeri, myslimanët, të krishterët dhe çifutët jetuan së bashku në paqe e harmoni në atë vend. Myslimanët kurrë nuk përdoren dhunën për t' i detyruar njerëzit të ndërrojnë fenë, ndonëse disa jomyslimanë e pranuan këtë fe me vullnetin e tyre të lirë. Paqja dhe harmonia në Palestinë vazhdoi aq kohë, as myslimanët qeverisën në rajonin. Por në fund të shekullit të XI, një pushtues nga jashtë, hyri në rajon dhe toka e qytetëruar e Jerusalemit barbarisht u plaçkit në mënyrë të tmerrshme Këta barbarë ishin kryqtaret.

EGËRSIA E KRYQTARËVE

Kryqtarët plaçkitën Jerusalem dhe i vranë të gjithë banorët e tij jo te krishterë. Kur anëtarët e të tre besimeve po jetonin në paqe dhe harmoni në Palestinë, të krishterët e Eo-

ropës vendosën të organizonin kryqëzatat. Duke iu përgjigjur thirrjes së papës Urban II, më 25 Nëntor 1095 në Këshillin e Klermontit, më shumë se 100,000 njerëz nga e gjithë Evropa u nisën për në Palestinë, që të 'çlironin vendin e shenjtë nga myslimanët' dhe të gjenin pasuritë përrallore të Lindjes. Pas një udhëtimi të gjatë dhe të lodhshëm dhe pas grabitjesh e masakrash të mëdha ndaj myslimanëve, ata arritën në Jerusalem në vitin 1099. Qyteti ra pas një rrethimi prej afër pesë javësh, dhe kryqtarët hynë në Jeruzalem. Ata ushtruan një egërsi që rrallëherë bota e ka parë. Të gjithë myslimanët dhe çifutët në qytet u shkuan në shpatë. Sipas fjalëve të një historiani, 'Ata i mbytën të gjithë Saraçenët dhe Turqit që i gjetën...ishin ata meshkuj ose femra.' [2] Një nga kryqtarët, Rajmond Aguiles, mburrrej me dhunën që kishte ushtruar personalisht Kishte pamje të mrekullueshme. Disa nga burrat tanë (e kjo ishte më meshiruesja) u prinin kokat armiqve të tyre; të tjerët i gjuanin ata me shigjeta, dhe ata rrëzoeshin nga kështjella. Të tjerët i torturonin ata më gjatë duke i hedhur në zjarre. Grumbuj kokësh, duarsh dhe këmbesh shiheshin nëpër rrugët e qytetit. Nevojitej që të zgjidhje rrugën mbi trupa burrash dhe kuajsh. Por këto ishin vetëm disa çështje të vogla, kur të krahasohen me atë se çfarë kishte ndodhur në Tempullin e Solomonit, vendi ku zakonisht bëhen shërbimet fetare. Në tempull dhe oborrin e Solomonit, burrat u lanë në gjak deri në gjunjët e tyre dhe kapistra frenash. (3) Brenda dy ditësh, kryqtarët oranë rreth 40,000 myslimanë në mënyrë barbare siç u përshkrua pakë më parë. (4) Paqja dhe harmonia që kishin mbretëruar në Palestinë nga koha e Omerit, përfunduan me një masakër të tmerrshme. Kryqtarët dhunuan të gjitha ligjet etike të krishterimit dhe përhapën terrorin në emër të Krishterimit.

DREJTËSIA E SALAHUDINIT

Ushtritë barbare të kryqtarëve e bënë Jerusalemin kryeqytet të tyre dhe ngritën Mbretërinë Latine, kufijtë e së cilës shtriheshin nga Palestina në Antioki. Sidoqoftë, kryqtarët që sollën egërsinë në Palestinë, nuk mundën të qëndrojnë gjatë. Salahudini i mbloodhi të gjitha mbretëritë myslimane nën flamurin e tij, në një luftë të shenjtë dhe i mundi kryqtarët në betejën e Hatinit në vitin 1187. Pas betejës, dy udhëheqësit e ushtrisë kryqtare, Rejnaldi i Shatijonit dhe mbreti Gij, u sollën para Salahudinit. Salahudini ekzekutoi Rejnaldin e Shatijonit, që njihej për barbaritë e tmerrshme që kishte kryer kundër myslimanëve, ndërsa mbretin Gij e la të lirë, pasi ai nuk kishte kryer krime të njëjtat. Palestina edhe një herë u njoh me drejtësinë e vërtetë. Menjëherë pas betejës së Hatinit dhe në të njëjtën ditë që Profeti Muhamedi a.s. ishte marrë nga Meka për në Jerusalem brenda natës, ditën e ngritjes, Salahudini hyri në Jerusalem dhe e çliroi atë nga 88 vitet e pushtimit kryqtar. Kur kryqtarët e kishin marrë qytetin 88 vjet më parë, ata kishin orarë të gjithë myslimanët në qytet dhe për këtë arsye, ata kishin frikë se mos Salahudini do të bënte me ta të njëjtën gjë. Por Salaudini nuk preku asnjë të krishterë në qytet. Por i urdhëroi të krishte-

rët latinë që të largoheshin nga Jerusalemi. Të krishterët ortodoksë, të cilët nuk ishin kryqtarë, u lejuan të jetojnë në qytet dhe të kryejnë falet si të dëshironin. Historiana britanike, Karen Armstrong, e përshkruan marrjen e dytë Islamike të Jerusalemit me këto fjalë: Më 2 Tetor 1187, Salahudini dhe ushtria e tij hynë në Jerusalem si mundës dhe për 800 vjetet që do të pasonin, Jerusalemi do të mbetej një qytet mysliman. Salahudini e mbajti fjalën dhe e mori qytetin sipas idealeve më të larta islame. Ai nuk u hakmor për masakrën e vitit 1099, sikurse këshillon edhe Kurani (16:126) dhe tani që armiqësitë kishin pushuar, ai u dha fund vrasjeve (2:193-194). As edhe një i krishterë i vetëm nuk u var dhe nuk u plaçkit. Shpërblezat për lirim ishin tejet të ulëta... Salahudini u prek e nga kursimet që familjet premtorin të jepnin si dëmshpërblim për lirim e robërve të luftës dhe i liroi shumë prej tyre falas, sikurse nxiste Kurani, megjithëse të ardhurat në thesar ishin pakësuar deri në një masë dëshpëruese. Vëllai i tij, El-Adili, ishte aq i pikëlluar nga gjendja e vështirë e robërve, sa që i kërkoi Salahudinit të blinte njëmijë prej tyre si skllvër për vete dhe sapo i mori, i liroi në çast që të gjithë... Kur Imad ad-Din e pa Patriarkun Herakliun duke e lëshuar qytetin me koçin e mbushur me thesar, ai e nxiti Salahudinin që t'ia konfiskonte atë. Mirëpo Salahudini e refuzoi. Kurani thotë se betimet dhe marrëveshjet duhet mbajtur saktësisht dhe ishte qenësore që muslimanet t'i zbatojnë ligjshmëritë... Herakliu pagoi dhjetë dinar shpërblese si gjithë të tjerët dhe iu ofrua shoqërim i posaçëm për ta ruajtur thesarin e tij gjatë udhëimit për në Tir. (5) Kjo tregon se Salahudini dhe myslimanët, nën udhëheqjen e tij, i trajtuan të krishterët me mirësi e drejtësi të madhe. Udheheqesi i ushtrive kryqtare, Rikardi Zemërluani, nuk ishte aspak bujar dhe hero por nje kriminel dhe vrases i pameshirshem. Pas Jerusalemit, kryqtarët vazhduan barbaritë e tyre dhe myslimanet drejtësinë e tyre në qytetet e tjera të Palestinës. Në vitin 1194, Rikard Zemërluani, që portretizohet si hero i madh në historinë britanike, ekzekutoi në kështjellën Akr 3,000 myslimanë, nga të cilët shumë gra e fëmijë. Megjithëse myslimanët qenë dëshmitarë të kësaj egërsie, ata kurrë nuk përdorën të njëjtat metoda. Sepse ata iu përmbajtën urdhëresës së Zotit, "Mos lejoni që urrejtja ndaj një populli që ju ndaloj një herë nga Xhamia e Shenjtë t'ju shtyjë në teprim..." (Kurani 5:2) Muslimanet gjithashtu nuk ushtruan kurrë dhunë ndaj civilëve të pafajshëm. Ata nuk përdorën kurrë dhunë të panevojshme edhe ndaj ushtrive kryqtare që arritën t'i mundin. Egërsia e kryqtarëve dhe drejtësia e myslimanëve treguan edhe një herë një të vërtetë historike: Vetëm një qeverisje e ndërtuar me parimet e Islamit u lejoi njerëzve të besimeve të ndryshme të jetojnë së bashku në Palestinë. Kjo qeverisje tolerante e muslimanëve vazhdoi edhe 700 vjet pas Salahudinit, veçanërisht gjatë periudhës së Perendorisë Osmane.

NJE EKSPOZITE QE E NDERON QYTETIN E SHKODRES

Kane kaluar pak kohe dhe me sakte eshte 16 janari i ketij viti, kur ne qytetin e Shkodres, i nderuari Sami Bicakani hapi nje ekzpozite te emertuar "Shkodra ne disa koleksione" e cila u be mikepritese per vizitoret ne oren 11 ne lagjen xhabiej, me daten 16 janar 2008 ,duke i dhene dhe nje vlere tjeter jetes kulturore ne qytetin e Shkodres, aq i njohur per ekspozita nga me te ndryshmet dhe nga me te larmishmet, qe trajtojne tematike, e cila gjithmone ka ngjallur interesin e publikut shkodran. Por, kesaj here ekspozita ishte nje risi ne jeten kulturore te qytetit te Shkodres, sepse tematika e saj behej e njohur per here te pare ne nje ekspozite publike ne qytetet. Ekspozita ishte e titulluar "Shkodra ne disa koleksione" me autor te nderuarin, Sami

Bicakani, cili ne Shkoder eshte i njohur si ekonomist i kualifikuar qe, duke punuar ne institucione te ndryshme, eshte nderuar dhe respektuar per nevelin kualitativ te punes qe ka kryer prane ketyre institucioneve. Por ,kesa rralle Shkodra e njohu kete zoteri edhe si nje koleksionist pasionant i cili, me nje vetmohim dhe pune te palodhur, kishte bere nje perzgjedhje per t'u patur zili e cila prekte fusha te panumurta nga aspekte te ndryshme te jetes kulturore , artistike, sportive, filatelie, numizmatike. Dhe vargu do te ishte edhe me i gjate, po te rendisnim te gjithë koleksionin qe z, Sami Bicakani kishte paraqitur per publikun qe ishte vizitor i kesa ekzpozite te rralle ne qytetin e Shkodres. Ekzpozita eshte hapur ne 70 vjetorin e datelindjes se z. Sami Bicakani dhe ai ne kete ekspozite ka paraqite vlere te historise se qytetit te Shkodres te

cilat jane ekspozuar ne stendat e kesaj ekspozite permes me se 850 objekteve qe zgjuan nje interes e jashtezakonshem tek vizitoret e kesa ekspozitete cilet shijuan vlere qe duket se kishin munguar ne formimin e tyre kulturor –qytetar. Kujtojme se i nderuari Sami Bicakani eshte anetar i shoqates se koleksionisteve shqiptare, dega Shkoder dhe anetar i federates se koleksionisteve shqiptare. Duke folur ne hapjen e kesaj ekspozite, vete autori, z. Sami Bicakani, tha se kjo ekspozite eshte frut i nje pune shume vjecare te cilen ai tha se do ta vazhdonte edhe ne te ardhmen, ku prioritet do te kete fusha e sportit, me synimin per te ekspozuar nje koleksion me filateli, foto etj. per sportin, me rastin e 90-vjetorit te klubit "Vllaznia", (1919-2009) , ne se ekipi do te dale sivjet kampion. Z. Sami Bicakani falenderoi edhe

familjen e tij e cila i ka dhene nje ndihmese te madhe per te ruajtur dhe sistemuar koleksionin e tij 50- vjecar. Ekspozita, megjithese qendroi e hapur vetem nje dite, ajo pati vizitore te shumte te cilet e falenderuan autorin per kete pune voluminoze dhe per perkushtimin e tij te lavderueshem ne ruajtjen e vlerave kulturore te qytetit te Shkodres, qe brezat e sotem dhe ata qe do te vijne me vone, te jene deshmirtare se Shkodra ka qene dhe do te mbetet nje djep culture, ku edhe nje ekspozite e thjeshte si ekspozita "Shkodra ne disa koleksione " e te nderuarit, Sami Bicakani, eshte deshmirtare e kesaj kulture qe eshte portreti i vertete i qytetit te lashte te Shkodres.

Selim Gokaj

ALKOOLI OSE LENGU QE VRET

Armet qe shfarosin njerezimin ne mase jane rezultati me tragjik i frymezimit nga shejtani ne jeten e njeriut. Ne nje linje me kete perfundim eshte edhe alkooli, i cili eshte nder shpikjet me shkaterruese te moralit njerezor dhe efektin shkaterrues e ka ne kohe lufte, por arrin kulmi e tij ne kohe paqeje. Sot, numerohen miliona njerez, te cilet vullnetarisht bejne pjese ne kete grup qe kane vendosur qe te behen shembull i keq per te tjeret dhe per vehten e tyre. Ata bien viktime e aksidenteve automobilistike, bien viktime dhe bejne te tjeret viktime ne ambjente normale dhe specifike si jane dasmat dhe gezimet e tjera ne jeten e njeriut. Mund te themi ne menyre te perafert se viktimat e perdorimit te alkoolit konkurojne ne numur me viktimat qe kane sjelle dhe sjellin luftrat ne jeten e njeriut. Te mos harrojme se kete armik te rrezikshem ne e trajtojme si mik duke e mbajtur prane vehtes dhe duke harruar se ai nje dite do te na shkatërrojë. Mashtrimi i perkoheshem, qe na ben alkooli me nje kenaqesi te perkoheshme, do ta detyroje perdoruesin e tij qe te jete i zbuluar edhe perballe mjekut, sepse alkoolisti nuk ka force

dhe vullnet qe te divorcohet nga ky leng, ku shejtani gatuan fatkeqesine e njeriut. Per ta shpetuar njeriun, qe eshte krijesa me e dashur per Allahun xh. sh., Ai ka derguar dispozita permes Kuranit te Madherueshem, ku ndalon perdorimin e ketij lengu vdekjeprures dhe shkaterrues te moralit njerezor. Te mos harrojme se arabet kane qene konsumatore te medhej te alkoolit, por pas urdherit te Allahut per ndalimin e tij, ata u larguan nga perdorimi i alkoolit duke respektuar disa faza qe perfunduan me ndalimine tij te plote nga muslimanet ne suren "Maide" ku Ai urdheron; "O ju qe besuat , s'ka dyshim se vera, bixhozi, idhujt dhe hedhja e shigjetes per fall, jane vepra te ndyra te shejtanit. Pra largohuni prej tyre qe te jeni te shpetuar. Shejtani nuk desheron tjetër, por permes veres dhe bixhozit, te shkaktoje armiqesi ne mes jush, t'ju pengoje nga te permendurit e Zotit dhe t'ju largoje nga namazi. Pas zbritjeve te ketyre ajeteve ne Kuranit i Madhnueshem, muslimanet, qe ishin duke pire, i ndegjuan keto ajete dhe i hodhen gotat per toke. Kurani Famelarte ka nje qendrim te prere ndaj perdorimit te alkoolit, qe

ndrim qe eshte i kundert me ata qe thojne librat e tjere para Tij. Profeti as. ka thene se cdo pije dehese eshte "hamer "(alkool) dhe cdo "hamer" eshte haram. (transmeton Muslimi). Kurani i Madhnueshem ndalon edhe sasine me te vogel te alkoolit per t'u perdorur. Te penalizuar per alkoolin jane edhe prodhuesit e tij, kerkuesit per prodhim, konsumuesi, transportuesi, shitesi ,bleresi dhe ai per te cilin eshte blere. Muslimani e ka te ndaluar te beje dhurate nje shishe me alkool edhe nje personi qe nuk eshte musliman. Perdoruesit e kesaj pijeje te rezikshme besojne se alkooli ka edhe veti sheruese te cilat hidhen poshte nga hadithet e Pejgamerit a.s. qe na kujton se alkooli nuk eshte sherim, por eshte semundje dhe se Zoti nuk e ka caktuar sherimin nga ajo qe i eshte ndaluar njerezimit. Di-jetari islam, Iben Kajjimi, ka thene se ...sa me i forte te jete imani i njeriut aq me i urryer eshte medikamenti i ndaluar dhe si rezultat alkooli eshte semurje dhe jo sherim. Por, muslimanet e kane te veshtire te marrin parasysh keshilla kaq te dobishme per shendetin e tyre. Ata jane te gashen te abandonojne mishin e derrit, sepse kane alternative te tjera ushq-

mi si: mishi i pules ,i vicit e tjere. Me qe nuk kane alternative tjeter per te mashtruar vehten me nje kenaqesi te perkoheshme , perdoruesit e alkoolin kane nxerre dhe nxerrin shume "shpikje" per te pranuar perdorimin e tij. Ne duhet te jemi te qarte se kush eshte e ndaluar dhe kush eshte elejuar per muslimanin, ndalesa dhe lejime qe e kane urdherin e tyre ne Kurantin Famelarte dhe ne nuk duhet te jemi ne konflik me Allahun xh.sh per hater te disa personave qe kane e vendosur t'i bejne karshillek fjales se Allahut dhe te shkatërrojne moralin e vet dhe te demtojne gjithashtu moralin e shoqerise njerezore. Te mos harrojme se jemi pergjegjes per veprat tona para Allahit xh.sh. dhe pergjegjesite, kur nuk zbatohen, edhe pasojat jane te renda per ata qe nuk i zbatojne .Allahu xh.sh. na meshirofte per gabimet tona dhe per fajet tona. Qofshin te meshiruar nga Allahu xh.sh. edhe ata qe pijn alkool, me premtimin per t'u larguar sa me shpejt prej ketij lengu qe e mbyt njeriun.

Bujar Shehu

PENDOHUNI QE ALLAHU T'JU MESHIROJE

Besimtaret muslimane dhe te tjere muslimane qe e kane te kufizuar shkallen e besimit ne fene islame, jane te kercenuar nga vepra e shejtanit, i cili perpiqet qe t'i beje muslimanet pjese e gjynaheve te medha dhe te vogla. Kjo eshte edhe arsyeja perse shume nga ne bejne gjynahe dhe pastaj pendohen per t'u kthyer perseri tek gjynahu, duke bere qe muslimane te tille te jene pasqyre e frikshme dhe e rrezikshme e vepres se shejtanit ne masen e muslimaneve. Ky kthim tek gjynahu nuk duhet te ndodhe per sa kohe ne jemi penduar per keto gjynahe dhe perpiqemi per te shmangur gjynahun dhe rruget qe te drejtojne tek gjynahu. Muslimanet jane te qarte se e kane obligim paresor qe te adhurojne Allahun xh.sh.me maksimumin e aftesive te veta intelektuale dhe me maksimumin e perkushtimit ne fene islame.Por, Allahu xh.sh.

eshte meshirues i pashoq .Prandaj, Ai na e lehteson detyrimin tone duke na thene se askush nuk eshte i ngarkuar pertej mundesive te veta...(2; 286 Bakare) Muslimani nuk duhet te harroje qe jeton ne nje bote te mbushur me gjynahe dhe me kenaqesi te rreme e cila, me perkrahjen e vazhdueshme te shejtanit, na percjell, pa e ditur te verteten, drejt gjynaheve ku edhe nefsi yne eshte nje pjese e rendesishme e rruges se gabuar qe ne bejme drejt gjynaheve. Rrugedalja per te shpetuar prej gjynaheve per muslimanin egziston, por ai duhet te jete i afte qe te gjeje keto rruge shpetimtare. Nje here Profeti a. s. e keshilloi Muallin:"Mos harro te thuash ne secilinnamaz:"OAllah!Mendihmo te te kujtoi, te te falenderoi dhe te adhuroj si duhet."Eshte e vetmja rruge, ne se duam te shpetojme,qe te kthehemi ne adhurimin tone ndaj Allahut xh.sh. dhe ta lusim qe te na ndihmoje te bejme ate

qe Ai na ka urdheruar. Kerkesa jone per falje dhe pendim tek Krijuesi i Gjithesise duhet te jete e vazhdueshme dhe jo vetem ,kur e ndjejme se jemi mbytur ne detin e pafund te gjynaheve. Ne Kuranin e madhnueshen thuhet qarte per muslimanin;"E t'i kerkoni falje Zotittuajdhependohuni ekthehuni tek Ai...(11;3 Hude). Dhe Allahu vazhdon te na porosise;"O ju qe keni besuar! Pendohuni tek Allahu xh.sh. me nje pendim te sinqerte,ne menyre qe Zoti juaj t'i largoje prej jush te keqiat dhe t;u dergoje ne xhenet ne te cili rrjellin lumej... (66:8) Et- Tahrim.Kur muslimani, per fat te keq, i kthehet perseri nje gjynahu, ai duhet te pendohet vazhdimisht qe te shpetoje nga rreziku i gjynaheve" Allahu e shtrin doren e tij gjate nates qe te pranoje pendimin e atyre qe kane bere gjynahe gjate dites dhe kjo do te vazhdoje deri sa dielli te linde nga Perendimi.(transmetom Muslimi). Por, Sheriati na kujton se pendimi

i sinqerte duhet te plotesoje disa kushte nga muslimani i cili kerkon te pendohet per gjynahet e tij.Kusht i rendesishem eshte qe ne duhet te fitojme mbi nefsin tone dhe te qendrojme larg ambjenteteve dhe njerezve qe mund te na percjellin drej gjynaheve. Por, me e rendesishmja eshte qe te bejme dua dhe t'i kerkojme Allahut xh.sh. qe te na jape force ,per te perballuar tundimin qe na shkakton shejtani qe kerkon te na i shtoje gjynahet dhe te na largoje nga rruga eAllahut xh.sh.Lusim Allahun xh.sh. qe te jemi pjese e atyre besimtareve muslimane te cilet do ta fitoje betejen e rende kunder gjynaheve duke rritur shkallen e devotshmerise ndaj fese islame dhe Allahut Xh sh.

Samir Hoxhiq

Nxenes ne Vitin i IV i medrezese "Haxhi Sheh Shamia Shkoder

FEJA ISLAME DHE NJERIU

Njeriun e ka krijuar Allahu ne menyre te persosur dhe fene islame ia ka derguar ne menyre te persosur qe eshte e shoqeruar edhe nga nje mesazh i persosur, qe duket tek libri madheshtor i cili ka zbritur per keto besimtare dhe qe eshte Kurani Famelarte.Prandaj, ne kete persosmeri, me i persosuri eshte besimtari, sepse ai ka pranuar dhe e ka bere te veten fene islame , Kuranin Famelarte dhe hadithet e Profetit Muhamedit a.s. Krijimi i njeriut eshte i persosur edhe ligji i zbritur per njerezimin, feja islame, eshte i persosur. Edhe ai, qe pershtatet me ligjin e All-llahut, eshte i persosuri, ku momenti me i persosur i ketij besimtari eshte adhurimi i Allahut xh.sh.Duke studjuar me kujdes shume momente te dijes islame, pranojme pa hezitim se rruzulli tokesor eshte nje shkollë dhe libri kryesor i saj eshte Kurani Fame-larte. Kurse, ne menyre te figurshme, Profeti Muhamedi a.s. eshte kryeredaktori i tij. Kurse, nxenesit jane besimtaret me teologet si mesues te tyre.Po te pranojme

kete portret te figurshem, do te kuptojme se feja islame nuk eshte prapambetje, por eshte perparim per te gjithë njerezimin, sepse me kete portret, Universi merr pamjen e nje universiteti qe kryen funksionin e nje laboratorit. Feja islame i urdheron njerezit, qe te studiojne dhe kete studim mos ta braktisin gjithë jeten e tyre, duke treguar se ajo kerkon qe njerezit te jene te ditur, se nga dija vjen perparimi dhe nga dija vjen edhe nje moral i paster, larg atij zhvillimi qe cenon jeten e njeriut ,moralin e tij dhe vete hapesiren, ku ai jeton ,planetin.Historia e vertete e njerezimit ka filluar ne momentin, kur Allahu xh.sh.ka filluar t'i dergoje atij profete permes te cileve kane filluar te duken tek njeriu vlerat me te mira te tij, duke filluar nga niveli i punes , kultura dhe morali i tij. Ndersa ata, qe nuk i kane pranuar profetet, kane gene njerez dhe popuj me nje moral te dobët dhe kane vepruar kunder urdherave te Allahut xh.sh, gjë qe ka sjelle edhe shkaterrimin e tyre.

Por, eshte e pranueshme qe ka besimtare te cilet kane nje moral te dyshimte dhe bejne veprime

që feja islame nuk i pranon, duke u dhene rastin jobesimtarve qe te shprehen per nje hipokrizi te shume besimtarve . Ne nuk duhet te ngaterrojme fene me besimtarin, sepse feja eshte nje ligj hyjnor qe duhet zbatuar pa te meta, kurse besimtari eshte nje njeri qe nuk mund t'i shpetoje gjynaheve qe mund te jene edhe gjynahe fetare per shkak se shume besimtare marrin nga feja ate pjese qe i intereson atyre, duke iu shmangur vlerave te tjera te fese qe jane te pafundme.Por, ketyre besimtareve te dyshimte, u kujtojme se gjerat, qe i ndalon feja dhe qe i zbatojne ata, ne dukje jane te shijshme , por helmi i tyre do t'u duket me vone, kur keto besimtare do ta kene te pamundur te shpetojne prej tyre.Allahu i ka krijuar njerezit ne menyre te persosur dhe pa te meta. Por, jane vete njerezit qe nuk i zbatojne urdhera e Krijuesit dhe me veprat e tyre shkaterrjne moralin e vet dhe moralin e njerezve te tjere, duke u larguar nga rruga e Krijuesit e cila eshte gjithmone rruga e vertete, ku ai duhet te levize.Per nje njeri besimtar, qe zbaton ligjet e Allahut, alkooli, duhani, bixhizi

jane vese qe i sjellim rrenim nje besimtari dhe nje njeriut te zakonshem i cili ka urdher hyjnor qe te qendroje larg ketyre veseve qe i shkaterrjne jeten e tij.Njerezit duhet te rrezojne pijetoret nga themelet. Por, ata qendrojne ne kembe edhe mbushen nga kliente ,qe pastaj rrezohen per te mos u ngritur ne kembe kurre me. Xhamija me pijetoren mund të jenë në një rrugë dhe është shumë e nevojshme të rrezohen pijetoret.Kultura mund te perparojë dhe te kape edhe majat por ajo, jashte nje morali te paster, sjell vetem shkaterrimin e shoqerise njerezore.Te mos harroje askush se duhet te kete kujdes qe ta zbatoje ne menyre sa me te plote ligjin e Allahut permes fese islame, sepse do te vije momenti ne boten tjetër, kur peshorja do te tregojë sa i vlefshem dhe sa besimtar ka qene njeriu ne kete bote.

Materjali eshte marre nga permbledhja "Aforizma"

Botohen me lejen e autorit Abdylkadir Haktanër

BOTA ESHTË E KERCENUAR NGA SKENARE TE RREZIKSHEM

Kriza ekonomike qe ka perfshire te gjithë boten, pa kursyer as shtetet me te fuqishme te planetit, ku si primadone jane SHBA nga ku edhe filloi kjo krize e rrezikshme, eshte bere lajmi i dites me trondites ne mediat e shkruara dhe ato vizive, ne takime dhe ballafaqime nga me masivet qe jane pare ndonjehere ne mes te politikaneve dhe ekonomisteve me te larte thujse te te gjithë shteteve te cilet bejne perpjekje qe ta amortizojne kete krize permes akordimit te fondeve marramendese qe kapin miliarda ero dhe dollare te cilat artikuloohen si masa shpëtimi per ekonomine e ketyre vendeve. Por, me gjithë kete angazhim kolosal monetar, kriza eshte kthyer ne nje virus qe po shkakton miliona te papune, ngecje te prodhimit te makinave dhe te treguesve te tjere te prodhimit industrial dhe bujqësor, duke e zvogluar ne minimum ate pjese te prodhimit qe nuk eshte prekur nga kriza ekonomike globale. Ata pasazhe qe u dhane me lart jane pjesa e jashtme, ose e thene ndryshe, pjesa e lexueshme e ketij fenomeni qe ka goditur ekonomine boterore. Por, pjesa e padukshme, qe publiku i gjere e ka te veshtire ta perceptoje, eshte ajo qe i shqetesonekspertet politike dhe ekonomike te cilet e ndjejne vehten te habitur nga

shpejtesia me te cilen kriza globale ekonomike shpertheu dhe u perhap. E ndjejne vehten te habitur edhe me vendin gjigant ku shpertheu dhe mbi gjithshka jane te habitur dhe te shqetesuar se kjo krize ekonomike shpertheu menjehere pas krizes se naftes, e cila solli nje rritje galopante dhe te papare te cmimit te naftes ne te gjithë boten, rritje qe solli shpenzime kolosale monetare per vendet e zhvilluara ekonomike dhe te ardhura te jashtezakonshme per vendet prodhuese te naftes. Te mos harrojme se te fituar ne kete krize naftë dolen vendet arabe, Venezuela, Irani, Rusia, vende qe nuk jane aq shume ne nje linje me politiken stategjike amerikane dhe si rrjellim pasurimi i tyre ne keto permasa ishte i padesheruehem per stafin politik, ekonomik dhe ushtarak qe drejton sot SHBA. Prandaj, ka mundesi qe kriza ekonomike globale mund te jete nje skenar per te ndaluar prodhimin e ekonomise boterore perkohesisht dhe ne permasa te tilla sa kerkesa per naftë te pesoje nje ulje drastike dhe per pasoje cmimi i naftes te bjere ne nje tatpjetje qe kerkon kohe per t'u ndalur. Sot nje barele naftë po shitet ne treg me 40 dollare nga 170 dollare qe pat arritur cmimi, kur kerkesat per naftë nuk njihnin kufij. Tashme balanca e fituesve dhe te humburve ka pësuar ndyshim polesh, ose rrokade.

Te fituar jane sot vendet e zhvilluara me SHBA ne krye te cilet kane ngecje ekonomike dhe kursejne shuma kolosale valute, sepse nuk po blejne naftë nga se prodhimi eshte ndalur ne menyre masive. Kurse te humbur jane vendet prodhuese te cilave nuk u shitet nafta dhe ajo qe shitet ka nje cmim shume te ulet. Para pak ditesh, mediat dhane nje lajm shume domethenes, sipas te cilit, vendet arabe deri para pak kohesh kane humbur 3 trilion dollare, pa folur per humbjet e Rusise, Venezueles, Iranit. Kurse skenaret ushtarake politike tashme jane shume te qarte, sepse ata filojne nga lufta e Bosnjes, skenar qe synonte te zvogelonte numurin e muslimaneve ne ate hapësire gjeografike gje qe u arrit duke lene nje lufte te vazhdoje kater vite e cila pati pasoje 200 mije te vrare, qindra mijra te plagosur dhe miliona te larguar, duke i shtuar edhe nje paqe tragjike per muslimanet e Bosnjes e cila ishte Paqa e Dejtonit, ne njekohe qe Mali i Zi megjithese kishte qindra mijra serbe ne territorin e tij beri nje ndarje "te bute" nga Serbia qe u karakterizua vetem nga replika por, pa nje pushke te shtene, se paku ne ajer. Bota u be deshmitare edhe e skenareve ekonomike me nje strategji te caktuar dhe me pikesynime te fshehura te cilat filluan me gripin e shpendeve te cilin mediat e la-

kuan aq shume, sa u krijua idea se popullata e planetit eshte ne prag te zhdukjes nga nje epidemi e gripit te shendeve, duke i dhene me kete rast nje goditje thujse shkaterruese industrise se prodhimit te mishit te pules, aq i desherueshem ne tregun boteror. Pastaj erdhi kriza e ushqimeve qe trefishoi cmimet e miellit, vojtit dhe te orizit, pa harruar derivatet e tyre. Publiku duhet te kete parasysh se keto skenare politike, ekonomike dhe ushtarake kane ndodhur ne nje afat kohor shume te shkurter dhe njeri pas tjetrit duke na bere te dyshojme per qendra dhe kupola qe "kane dore ne keto skenare", ose me sakte i pergadisin dhe i menaxhojne keto skenare. Po kush jane ata qe e kane "doren kaq te gjate" per te bere lemshe dhe turbullira ne bote dhe per t'i menaxhuar keto lemshe dhe turbullira ne interes te nje grupi super te pasur dhe qe del gjithmone i fituar me keto skenare?

Mendojme se per te mesuar se kush qendron pas ketyre skenareve, publikut te gjere i rekomandojme qe te lexoje botimin e fundit te autorit amerikan, Xhim Marris "Kush e sundon boten", sepse aty ai do te mesoje se kush jane autoret e vertete te ketyre skenareve qe po trondisin sot boten.

Alban Kastrati

OBAMA DEKLARON SE IRANI ESHTË SUPERFUQI REALE

Ne konferencen e tij te pare shtypi, pasi eshte ulur ne karriken e presidentit te SHBA, Barak Obama ka folur edhe per raportet e reja qe do te vendose qeveria e presidentit te ri me shtetin islamik e Iranit, aq i lakuar dhe aq shqetesues per diplomacine amerikane dhe politiken e superfuqise se vetme te botes. Ne deklaraten e presidentit Obama te ben pershtypje menyra realiste e trajtimit te fenomenit "Iran" e cila duket qe te fillim te trajtimit te saj ne kete conference shtypi. Obama e quajti Iranin qe superfuqi reale e cila

duhet trajtuar nga politika amerikane ne frymen e bashkepunimit, duke u perpjekur te evidentohen hapësirat dhe mundesite e bashkepunimit ne mes te dy shteteve per probleme te rajonit dhe me gjere, ku eshte i nenkuptuar roli i Iranit per te qetesuar situaten e rende ne Afganistan ne te cilin influenca e Iranit eshte shume e fuqishme, sidomos ne nje pjese te fraksioneve qe luftojne kunder trupave amerikane dhe aleateve te tyre evropjane. Lajmi eshte dhene nga stacioni radiofonik "Zeri i Amerikes" ne nje emision te zakonshem mengjezi, duke treguar se tashme politika e ashper qe zbatoi Bushi dhe sta-

fi i tij ndaj Iranit ishte i deshtuar dhe se vendin e saj do ta zere nje politike me realiste nga qeveria e presidentit te ri amerikan qe ka si pikesynin uljen e tensioneve ne mes te dy vendeve si dukuri e bashkepunimit dhe jo e konfrontimit qe eshte edhe strategjia e re e qeverise se presidentit Obama. Por Obama i kujtoi Iranit se nuk do te tolerohet mbeshtetja e Iranit per organizatat terroriste, duke nenkuptuar mbeshtetjen e forte qe Irani i jep Hamasit dhe Hesbullahut, te cilet amerikanet i kane etiketuar si organizata terroriste. Fjala e presidentit Obama ne kete conference shtypi tregon se ne po-

litiken amerikane po fryn nje ere e re e cila do te korigojte dhe do te amortizojte politiken e ashper dhe te rrezikshme te ish-presidentit Bush e cila e vuri boten e qytetruar ne nje pozite te veshtire dhe po kaq ne pozite te veshtire e vuri edhe prestigjin e SHBA qe pati per pasoje luftera dhe perplasje, ku viktimat nuk munguan as nga rradhet e atyre qe u sulmuan, as nga rradhet e ayre qe sulmuan

Iformacion mediatik

SERBET PAGUAJNE PER SHKATERRIMIN E XHAMIAVE NE BOSNJE

Axhensite e lajmeve bejne te ditur se autoritetet serbe te Bosnjes do te paguajne nje shume prej 42 milion dollaresh si demshperblim per shkaterrimin nga ana e tyre te xhamiave dhe veprave te tjera te kultit te cilat ekalojne numurun 1000 gjate krimeve qe bene ata ne vitet 1992-1995 ku rrenimi i objekteve fetare muslimane ishte pjese e rendesishme e strategjise se tyre per te zhrrenjose elementin musliman nga hapësira e Bosnjes si element i politikës me te larget per te pase sa me pak muslimane ne Bosnje dhe net e gjithë Ballkanit. Sidomos shkaterrimi i xhamiave muslimane ishte nje dukuri e dhimshme qte cilen e perjetuan muslimanet

ne bosnje dhe me gjere epse viktime e kesaj masakre u bene xhamia shume te vjetra si : Xhamia Ferhadie, xhamia madheshtore ne Foca, pa harruar edhe xhamite madheshtore ne Banja Luka. Megjithese serbet rrafshuan mbi 800 xhami ne Bosnje luftetaret e armates muslimane te Bosnjes nuk preken as nje kishë te serbeve. Kryetari i Bashkesise Islamike te Bosnjes Resul Ulemaja Mustafa Cerić do te deklaronte se luftetaret boshnjake muslimane emoren mesazhin tone se nuk duhej cenuar asnje kishë serbe ne Bosnje, mesazh qe ata e respektuan ne menuren me rigoroze duke treguar vlerat e moralit qe percjell feja islame te cilat duhe respektuar edhe ne situatë te nje lufte te ashper kur krimet ku-

nder popullsise muslimane jane nga me mizoret. Ne nje deklarate mediatike te bere nga komuniteti musliman i Banja Ljukes thuhet se detyrimi i serbeve te Bosnjes per te zhdemtuar muslimanet per shkaterrimin e xhamiave te tyre qe erdhi pas vendimit te njegjykate ishte nje fitore emadhe per muslimanet ne Bosnje sepse serbet u detyruan te pranojne publikisht fajin e tyre te rende i cili ka te beje me shkaterrimet e veprave te kultit te fese islame nga ana e tyre ne konfliktin nderfetar dhe etnik te cilin e perjetoi Bsnja gjate luftes se viteve 1992-1995 ku masakrat kunder muslimaneve jane nje Holokaust i ri pas atij te Luftes se dyte boterore ku humben jeten 50 milion njerëz dhe miliona te tjere u plogosen ose

u zhduken. Tashti eshte rralla e serbeve te Beogradit dhe e serbeve te Kosoves qe te paguajne per djegjen e dhjetra xhamiave ne Kosove gjate luftes se viteve 90,ose t'i ndertojne te reja si ua ndertoi qeveria e Kosoves serbeve kishat e djegura ne mars te vitit 2006 pas revoltave massive te kosovareve qe maren shkak nga mbytja ne lumen Iber ne Mitrovice te dy femijve kosovare te cileve serbet e Mitrovices u paten leshuar qente per t'i coptuar dhe ata per te shpetuar nga qente dhe turma e egersuar e serbeve qe i ndiqnin prapa u hodhen en lume ku gjeten vdekjen.

Selim Gokaj

A MUND TE BEHET NJE POLITIKAN SHQIPTAR PJESE E XHEMATIT TE XHAMISE

Ne nje shkrim te botuar ne nje te perditshme te mediave shqiptare ditet e fundit, eshte trajtuar problemi ne se edhe ne Shqiperi nje politikan musliman mund te jete praktikant i fese islame , praktikim te cilin ai mund ta deklaroje ne menyre te hapur duke qene pjese e xhematit te nje xhamie. Autori i shkrimit , Hamdi Nuhija, eshte i njohur si gazetar dhe analist i problemeve qe kane te bejne me fene islame dhe e provon me sukses penden e tij edhe ne poezi te cilat kane pikerisht nje tematike qe ka te beje me fene islame. Me te drejte autori u kerkon politikanëve shqiptare qe ata te jene pjese e xhematit te xhamive (kuptohet se fjala eshte per politikanet muslimane) ne menyre qe te jene pjese shpirtore e elektoratit qe u ka dhene voten. Pavaresisht nga qelimi i mire nga eshte nisur Hamdi Nuhija per te afruar politikanet shqiptare prane veprave te kultit te fese islame , mendojme se qe te realizohet kjo thirrje duhen pare se pari specifikat qe e portretizojne sot xhematin e xhamiave muslimane dhe pozicioni politik i muslimaneve ne hapësirat shq-

iptare, si mbrenda kufijve te Shqiperise londineze dhe jashte hapësirave te saj. Eshte e vertete qe ne politiken shqiptare sot jane te angazhuar nje grup i madh politikanesh shqiptare muslimane, sepse vete popullsia muslimane ne hapësirat shqiptare eshte shumice dermuese, por qe e ka te vogel hapësiren per te qene pjese e xhematit te nje xhamie , sepse ata nuk mund te jene te perjeshtuar nga presioni psikologjik qe bejne mediat shqiptare dhe te huaja edhe mbi muslimanet shqiptare , presion qe behet duke etiketuar muslimanet si rrezik global , terroriste ,atiprendimore, anti-amerikane dhe po te vazhdojme te rrallisim keto "anti" te muslimaneve ,do te na duhej te sakrifikonim thujse te gjitha faqet e ketij shkrimi. Ne jemi deshmitare per misionin dashakeq te mediate shqiptare qe nuk pertojne te mbushin faqet me atentate terroristesh, me plane te Al Kaedes fantazem, ku si ushtarë ka gjithmone islamike, nje emertimi i shpikur dhe shume i rrezikshem qe penalizon muslimanet ne te gjitha hapësirat ku ata jetojne. Eshte rasti te kujtojmë nje ankete te bere me deputetet muslimane te parlamentet shqiptare te cilet

pyetjes, ne se mbajne ramazan, iu pergjigjen thujse ne unitet se ata e quajne vehten pjese e atyre qe nuk mbajne ramazan, te bindur se nje deklarate ndryshe do te penalizohej nga mediat qe jane te gatshme te "peshkojne" informacione, ku "peshku" i rene ne rrjete, duhet te jete nje musliman, sepse ne kete menyre gazeta do te jete edhe me e lexueshme dhe per rrjellim edhe me e shitur. Krejt e kunderta ndodh me politikanet e Perendimit dhe te shteteve qe jane fqinje te Shqiperise te cilet jane ne menyre te hapur praktikues te zellshem te fese se tyre dhe, per te realizuar politiken e tyre dhe strategjine e saj, i kerkojne mbeshtetje fese se ciles ata i luten. Ne kemi pare ne media vizive prifiterinj qe marrin pjese ne ceremoni politike dhe shteterore, duke bekuar presidente dhe kryetare qeverish. Kemi pare prifiterinj ortodokse e katolike , rabine hebrej dhe derivate te tjera fetare qe i japin edhe tonin politikave qeveritare. Bush i madh dhe Bush ivogel kane qene frekuntues te rregullt te kishave dhe po nga keto kisha ata kane prezantuar edhe platforma te rrezikshme politike si ajo qe beri Bushi i Vogel, kur

nga salla e nje kishë, ku po behej lutja fetare, deklaroi se tashme kane filluar perseri kryqzatat si mase kunder sulmeve te kontestuar te 11 shtatorit. Te kujtojmë gjithashtu rolin percaktues qe ka kleri dhe prifiterinjte ortodokse ne politiken serbe dhe greke, pa lene ne harrese se ne shtetin hebre rabinet ultraortodokse jane frymezim dhe mbeshtetje per politiken e eger qe ben shteti hebre ne Lindjen e Mesme dhe ne te gjithë boten, Nga sa u theksua ne kete analize modeste, qarte-sohet idea se politika shqiptare eshte vasale ndaj shume shteteve dhe supershteteve dhe se dukuri e ketij vasaliteti eshte edhe qendrimi i politikanëve muslimane shqiptare larg xhematit te xhamiave si pjese e perpjekjeve te tyre te stermundshme per te qendruar ne politike per te cilen ata jane te gatshem per te paguar nje "takse" edhe me te rende, se sa qendrimi i tyre larg dyerve te nje xhamie.

Opinion mediatik

MADHESHTIA E EZANIT

Ezani thërret qiellin përshkon,
 Drita e besimit çdo qelizë përçon.
 Nga minaret fuqishëm buçet,
 Shprehje madhështore, forcë, dinjitet.
 Me freskinë e vet shpirtrat përkëdhel,
 Mendja zgjohet nga gjumi i thellë.
 Zemrat i ngroh si rrezet e diellit.
 Ti vërtetë je bilbili i qiellit.
 Shpirti i minares besimtari vet,
 Lum si ai që këtë çelës ka gjet!
 Dyert e lumturisë me te i hap,
 Lartësitë e fitores me te i kap.
 Kudo që thërret Zani i Muhamedis:
 Grishje fisnike i ban njerëzisë.
 Ashtu sot në Shqipninë tonë:
 Zani i Islamit gjithandej jehon.
 Ku janë ata, ku e kishin toruan,
 Kur mendja iu tha: se Dritën e shuan?

Veten tuej kurrë mos e gënjeni,
 Të njëjtin përfundim gjithmonë do t' keni.
 Por humbja asht fitorja juaj,
 As shqiptar s' ishit, por pjellë e huaj.
 Islami asht shpëtim e krenari,
 Allahu e dhuroi me mëshirën e Tij.
 Sado erna t' fryejnë ... e t' prishet moti...
 Fitorja asht e jotja se vjen nga Zoti!
 Drita e Allahut gjithmonë do t' ndriçojë,
 Myslimanët e denjë do ta reflektojnë.
 Për derisa bota frymëmarrje të ketë,
 Islami fitues gjithmonë do të jetë!
 Me madhni t' vet Allahu e garantoi,
 Në lavhin mahfull, Ai vet e shkroi!
 E këto vargje i shkroi Burhani,
 Jabanxhi, Jetim Zamani.

Burhan FILI
Michigan

Firma ILIRIA sh.p.k. me qendër në Shkodër



Mobil/Cel: 00355 (0) 69 2523565

Space-center

Qendra e internetit space-center ju ofron:

- internet te shpejte,
- shperndarje interneti,
- programe te ndryshme,
- cd, dvd, mp3,
- servis kompjuterash
- printime, skanime, etj.

Te gjitha keto me nje sherbim cilesor e te kulturuar.
Jemi hapur cdo dite nga ora 08:00 deri 23:30.

Adresa: pallati xhenis pas rektoratit te universitetit
"luigj gurakuqi", kati I

Kontakte:

- e-mail: spacecenter@live.com
- Cel. 0693253723 / 0672944162

بِسْمِ اللّٰهِ الرَّحْمٰنِ الرَّحِیْمِ
BISMIL-LAHIRR-RAHMANIRR-RAHIME

Tregtojme
MISH HALLALL

E XHUMA PUSHIM → BESNIK ALUSHI ISMETI

Produkt Hallall

**KLIENTË TË NDERUAR!
VËLLEZËR DHE MOTRA MUSLIMANË,
MARKET "ISMETI" JU GARANTON**

**1- Produkte mishi hallall si:
sallam, suxhuk etj.**

2- Piceri hallall

3- Fast Food hallall

**Ju keni të drejtë të blini ku të doni
por hallalli i vërtetë është vetëm
tek market "ISMETI"**

Adresa: Pranë teatrit "MIGJENI"
Cel: 0692101893